

E DREJTA PARLAMENTARE DHE POLITIKAT LIGJORE

2001

Në këtë numër:

Opinione për Politikat Ligjore

- Mbi organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë

E Drejta Parlamentare

- Kontrolli Kushtetues
- Pyetjet dhe Interpelancat
- Kontrolli i legjislativit mbi ekzekutivin, roli i Komisioneve Parlamentare

2

Botimi i Qendrës Studimore
Mbi Praktikën Parlamentare
Dhe Demokratike

PERMBAJTJA E REVISTES:

Numri II, viti 2001

	Faqe
Opinione mbi politikat ligjore:	3
❖ Mbi organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë	
- Sokol Azizi, Sekretar i Komisionit të Përhershëm Parlamentar të Ligjeve	5
- Pal Dajçi, Zv. Kryetar i Komisionit të Mandateve, Imunitetit dhe Rregullores	8
Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend	13
E Drejta Parlamentare:	
Një vështrim i shkurtër për Kontrollin Kushtetues, Sokol SADUSHI	24
Pyetjet dhe interpelancat – mjet i rëndësishëm i kontrollit parlamentar, Viktor GUMI	31
Kontrolli i Pushtetit Ligjvënës ndaj Organeve Ekzekutive dhe roli i komisioneve parlamentare për këtë problem, Sefedin GURI	36
Informacion mbi veprimtaritë e organizmave ndërkombetare, Leon SHESTANI	42
Aktivitetet e Qendrës Studimore mbi Praktikën Parlamentare dhe Demokratike, Elira ZAKA	47
Përmbledhje e përkthyer në anglisht:	53
Opinione mbi Politikën Ligjore	53
Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend	62

TABLE OF CONTENTS:

Issue 2, year 2001

	Page
Opinions about Legal Policies:	3
❖ About the Organization and Functioning of the Prosecutor's Office in Republic of Albania:	
- Sokol Azizi, MPs, Secretary of the Law Parliamentary Committee	5
- Pal Dajçi, MPs, Deputy Chairman of the Parliamentary Committee on Mandates, Immunity and Rules of Procedure	8
Information on Laws Passed by Assembly	13
Parliamentary Law:	
Short View on the Constitutionality Control of Laws, Sokol SADUSHI	24
Questions and Interpellation – Important Instruments for the Parliamentary Control, Viktor GUMI	31
The Control of Legislator upon Executive and Parliamentary Committees' Role in this subject, Sefedin GURI	36
Information about International Assemblies' Activities, Leon SHESTANI	42
Activities carried out by the Study Center on Parliamentary Practices and Democracy, Elira ZAKA	47
Summary in English :	53
Opinions about Legal Policies	53
Information about Laws Passed by the Assembly	62

Kjo rubrikë synon paraqitjen e politikave ligjore, në mënyrë të paanshme dhe objektive. Publiku dhe subjektet e interesuara duhet të jenë të qartë për debatin politik dhe për qëndrimet e forcave të ndryshme politike për çështje të rëndësishme që prekin interesa të një kategorie të gjerë njerëzish. Publiku është njëkohësisht dhe zgjedhësi, dhe, në këtë kontekst ai duhet të ndërjegjësohet për qëndrimet dhe pikëpamjet e forcave të ndryshme politike. Në këtë numër të Revistës është përzgjedhur projektligji “Për Prokurorinë në Republikën e Shqipërisë” si një çështje ligjore e rëndësishme në kuadrin e reformave institucionale në vendin tonë.

Projektligji “Për Organizimin dhe Funksonimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”

*Sokol Azizi
Deputet,
Sekretar i Komisionit të Përherëshëm të
Ligjeve në Kuvendin e Shqipërisë
Grupi Parlamentar i PS*

Projektligji “Për Organizimin dhe Funksonimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” është jo vetëm një nga aktet më të rëndësishme të veprimtarisë së ligjvënësit, por edhe një nga evenimentet e reformës së plotë që është duke u bërë në sistemin e drejtësisë dhe konkretisht në atë të Prokurorisë. Domosdoshmëria e hartimit dhe miratimit të këtij projektligji është pjesë e detyrimit kushtetues që deri tani ka pasur vakuum. Një nga elementet më kryesore të Kushtetutës, dhe pikërisht në kreun e dhjetë të saj, në nenet 148 dhe 149, shtrohet detyrimi i organizimit dhe funksionimit të Prokurorisë me ligj të veçantë, pra, organizimi i një organi të tillë të ngritur mbi bazën e centralizmit të veprimtarisë, duke iu nënshtruar vetëm Kushtetutës dhe ligjeve. Moment tjetër që përcakton domosdoshmërinë dhe rëndësinë e këtij projektligji është se Prokuroria në përputhje dhe me legjislacionin procedural penal dhe marrëveshjet ndërkombëtare, do të mbulojë edhe fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja të ndjekjes penale, si me INTERPOL-in dhe me Prokurorinë e Krimit. Për të krijuar një përfytyrim të qartë për konturet dhe organizimin e institucionit të Prokurorisë, vlen të parashtrijmë elementet më kryesore të këtij projektligji.

Në kreun e parë pasqyrohen nëpërmjet dispozitave të përgjithshme elemente të tilla si objekti i ligjit dhe i veprimtarisë së prokurorëve dhe baza ligjore mbi

të cilën ngrihet veprimtaria e prokurorit. Sanksionohet se organi i Prokurorisë dhe vetë prokurorët në ushtrimin e detyrës së tyre do të mbështeten vetëm te Kushtetuta dhe ligjet përkatëse, parim i cili del si detyrim nga neni 148 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Organi i Prokurorisë e mbështet veprimtarinë e tij ligjore në parimin e procedimit të drejtë, të barabartë dhe të rregullt, duke garantuar respektimin në thelb të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të interesave të tij të ligjshme. Në këtë projektligj, megjithëse në tërësi flitet për organin e procedimit penal, duke përfaqësuar akuzën, nuk harrohet të ndërfitet dhe politika morale-sociale që duhet të ushtrojë ky institucion, duke pranuar faktin tashmë të inkluduar në këtë projektligj, që dhe vetë Prokuroria organizon dhe bashkëpunon me institucionet e tjera shtetërore publike e private në veprimtaritë për edukimin e shoqërisë, për parandalimin e krimit dhe edukimin ligjor.

Në kreun e dytë të projektligjit janë parashikuar detyrat dhe përgjegjësitë e Prokurorit të Përgjithshëm, ku vlen të përmendet se shkon në mënyrë fare analoge detyrimi kushtetues i nenit 149 dhe detyrat e të drejtat e Prokurorit të Përgjithshëm për emërimin, transferimin, ngritjen dhe shkarkimin në detyrë të prokurorëve, element ky i centralizimit dhe organizimit të mirë të këtij institucioni.

Në kreun e tretë përcaktohet struktura dhe funksionet kryesore të Prokurorisë së Përgjithshme. Vend të veçantë zënë drejtoritë e hetimit dhe kontrollit të ndjekjes penale, si dhe ngritja e një numri të reduktuar drejtorish, që kanë për objekt të veprimtarisë së tyre marrëdhëniet juridiksionale me jashtë, administrimin e dokumentacionit të personelit, kontrollin e veprimtarisë së prokurorëve për çështje të veçanta. Nisur nga nevoja dhe domosdoshmëria e rritjes së nivelit profesional për t'iu përgjigjur më mirë dhe më shpejt kushteve specifike të organizimit të krimit dhe kriminalitetit në tërësi, në kreun e katërt, përcaktohet që organi i Prokurorisë, si të gjitha institucionet e shërbimit civil (por që nuk bën pjesë në të), nuk përjashton nga vetja, nëpërmjet projektligjit, detyrimin e funksionimit të konkursit për emërimin e prokurorëve, detyrë që kryhet nga Këshilli i Prokurorisë, organ që ngrihet për herë të parë me ligj. Në

ligj është përcaktuar edhe përbërja e këtij Këshilli, vendi që ai zë në Prokurorinë e Përgjithshme, roli që luan dhe mënyra e funksionimit të tij. Duke qenë organ i procedimit penal, pra përfaqësues i akuzës në gjyq në emër të shtetit, në projektligj vlerësohet si element shumë i veçantë (në kreun e pestë) dhe vendosja e marrëdhënieve jo të varësisë me gjykatat, por të bashkëpunimit për të kryer të njëjtin objektiv, atë të ruajtjes dhe mbrojtjes së të drejtës së shtetasit nëpërmjet respektimit të ligjit. Është përcaktuar struktura e prokurorive, struktura të veçanta të prokurorisë pranë Gjykatës së Lartë, gjykatave të apelit, gjykatave të rretheve, si dhe pranë çdo gjykate tjetër të krijuar me ligj. Gjithashtu, janë përcaktuar edhe kushtet konkrete për emërimin e prokurorëve, krijimin e Këshillit të Prokurorisë, për rastet e procedimeve disiplinore ndaj prokurorëve, si dhe statusi i prokurorit, elemente të cilat, në tërësinë e tyre, përkufizojnë detyrën e prokurorit, për realizimin dhe përmbushjen e misionit të prokurorit në procesin penal dhe në ngritjen e këtij misioni në stadin që kërkon realiteti i sotëm. Në praktikën e deritanishme të funksionimit të Prokurorisë, jo rrallëherë janë ndërtuar raporte të padrejta midis politikës dhe organit të ndjekjes penale, midis Ekzekutivit dhe Prokurorisë, midis ligjit të shkruar dhe moszbatimit të tij. Kjo për shkaqe që të gjithë i njohin, ose për faj të sistemit politik, ose për shkak të paragjykimit për veprimtarinë e këtij organi etj. Por në fund të fundit nuk është e thjeshtë të ngresh një organ të procedimit penal në realitetin e tanishëm dhjetëvjeçar të shtetit të së drejtës, për faktin se në një shtet demokratik shpeshherë ngatërrohen hapësirat se ku fillon dhe ku mbaron e drejta dhe detyrimi ndaj shoqërisë dhe ligjit. Nisur nga këto, duhet theksuar se ngritja e një institucioni të tillë, në rastin konkret të Prokurorisë, që në vetvete do të jetë i centralizuar, në kuptimin e funksionit dhe të organizimit të strukturave të saj, të centralizuar në veprimtarinë hetimore ndaj veprës penale, të centralizuar që nga ngritja në detyrë e shtetasit dhe shkarkimi nga ajo, pa dyshim do të japë rezultatet e veta në rritjen e përgjegjësisë për kryerjen e detyrës dhe në angazhimin në nivel më të lartë të vetë Prokurorisë në luftën kundër krimit.

Efektet i këtij projektligji do të duken edhe në mosndërhyrjen e pushteteve të tjera te Prokuroria.

Projektligji “Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”

Pal Dajci

Deputet,

Zv. Kryetar i Komisionit të Mandateve,

Imunitetit dhe Rregullores

Grupi Parlamentar i PD

Prokuroria është autoriteti i cili ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Mirëfunksionimi i Prokurorisë është i lidhur me mirëfunksionimin e shtetit ligjor dhe të demokracisë. Pushteti i ndjekjes penale është pushteti më i rëndësishëm për mirëfunksionimin e drejtësisë penale. Përvoja ka treguar se ata që zotërojnë këtë pushtet mund ta shpërdorjnë ose ta përdorin si mjet shtypës. Veprimtaria praktike e Prokurorisë gjatë këtyre tre vjetëve ka treguar se ajo është përdorur si mjet për të shtypur opozitën dhe jo si mjet për të luftuar krimin dhe kriminalitetin. Fakti, që pa asnjë shkak vazhdon të mbahet në ndjekje penale lideri i opozitës dhe shumë drejtues të tjerë të saj, tregon përdorimin e saj si mjet shtypës. Edhe fakti i mosndjekjes ose lojërat me arrestimet dhe lirimet e shumë kriminelëve të njohur për lidhjet e tyre me pozitën tregojnë mungesë dëshire të këtij organi për të luftuar krimin dhe kriminelët. Shpërdorimi i këtij pushteti është faktor destabiliteti dhe mirëfunksionimi i tij është faktor stabiliteti. Të gjitha këto tregojnë se rregullimi ligjor i veprimtarisë së Prokurorisë, për të parandaluar këto shpërdorime dhe për të siguruar funksionimin normal të saj për përmbushjen e detyrës së ndjekjes penale, është i një rëndësie të veçantë.

Projektligji bazohet në pesë elemente kryesore, të cilët janë: parimet mbi të cilat ngrihet organizimi dhe funksionimi i Prokurorisë; strukturat organizative dhe kompetencat e secilës strukturë; emërimi dhe procedimi disiplinor i prokurorëve; statusi i prokurorëve, si dhe marrëdhëniet e prokurorisë me organet e tjera të shtetit. Në aspektin teorik këto elemente i gjejmë në të gjitha ligjet organike siç është edhe ky projektligj. Rregullimi i plotë i secilit element plotëson në tërësi qëllimin e ligjit. Por mendoj se elementet e këtij ligji nuk janë trajtuar në mënyrë të plotë dhe të qartë. Kjo bën që projektligji të mos i shërbejë qëllimit për të cilin ai është paraqitur. Në relacionin shoqëruar të projektit është përcaktuar se qëllimi i projektit është përmbushja e detyrës kushtetuese të përshtatjes së ligjeve me Kushtetutën. Por mendoj se qëllimi i vërtetë i tij është kthimi i plotë i Prokurorisë në një vegël politike për të shtypur opozitën. Nëse do të bëhet një krahasim i këtij projektligji me ligjet që ekzistojnë para vitit 1990 lidhur me Prokurorinë, do të shohim ngjashmërinë që ekziston midis tyre. Edhe nga këshillimi me specialistë të kësaj fushe më ka rezultuar se ky projektligj është rikthim tek modeli i Prokurorisë që ishte para vitit 1990. Shqipërisë i duhet të shkëputet nga modelet e sistemit komunist. Kuvendi dhe gjithë organet e shtetit janë angazhuar për ndërtimin e shtetit sipas modeleve të demokracisë perëndimore. Një detyrim i tillë i del Shqipërisë edhe nga nënshkrimi i konventave europiane. Nisur nga këto angazhime e detyra, projektligji për Prokurorinë duhet të përshtaste një nga modelet e vendeve perëndimore dhe jo të kthehej tek modelet e vjetra komuniste, të cilat dihet se çfarë pasojash të këqija sollën për njerëzit dhe shoqërinë. Mendoj se projekti përmban shumë mangësi dhe duhet të kthehej për t'i rregulluar ato. Mangësitë janë teknike dhe parimore. Nuk do të ndalem në mangësitë teknike, pasi mendoj se mangësitë parimore janë më të rëndësishme. Vërejtjet për mangësitë e këtij projekti janë këto:

1. Projekti nuk përputhet me Kushtetutën tonë. Neni 148 pika 2 e Kushtetutës përcakton se prokurorët janë të organizuar dhe funksionojnë pranë sistemit gjyqësor. Kjo do të thotë se Prokuroria duhet të jetë e

organizuar dhe të funksionojë pranë tre shkallëve të pushtetit gjyqësor. Pra, duhet të ketë prokurori të shkallës së parë, prokurori të shkallës së dytë dhe prokurori pranë Gjykatës së Lartë. Këto duhet të jenë tri organet e Prokurorisë. Funksionimi i Prokurorisë sipas këtyre tri niveleve përcaktohet edhe në Kodin e Procedurës Penale, i cili sipas këtij projekti mbetet i pandryshuar. Nisur nga ky përcaktim kushtetues, Prokuroria e Përgjithshme nuk mund të funksionojë si strukturë më vete, por si strukturë pranë Gjykatës së Lartë. Prokuroria e Përgjithshme nuk është një përcaktim kushtetues dhe kjo bëhet me qëllim për të veshur me pushtet absolut Prokurorin e Përgjithshëm.

2. Nuk ka një përcaktim të qartë se në cilën degë të qeverisjes përfshihet Prokuroria. Ky përcaktim është i domosdoshëm për të përcaktuar parimet mbi të cilat duhet të ngrihet Prokuroria. Kushtetuta e përcakton këtë si pjesë të gjyqësorit, ndërsa organizimi e funksionimi i saj në këtë projektligj paraqitet si degë e ekzekutivit. Centralizimi, urdhrat e Prokurorit të Përgjithshëm dhe orientimet e Qeverisë e bëjnë atë organ ekzekutiv dhe jo gjyqësor.

3. Përcaktimi i Këshillit të Prokurorisë si organ këshillimor e bën atë një strukturë formale për të justifikuar abitraritetin e Prokurorit të Përgjithshëm. Ky këshill, nëse duhet të ekzistojë, duhet të jetë vendimmarrës, i ngjashëm me Këshillin e Lartë të Drejtësisë për sa i përket disiplinimit dhe emërimit të prokurorëve.

4. Procedurat e emërimit duhet të jenë të tilla, që të nxisin profesionalizmin dhe pavarësinë e prokurorëve. Procedura e emërimit që paraqitet në këtë projekt nuk është e tillë. Përdorimi i termit konkurim është formal, përderisa Prokurorit të Përgjithshëm i lihet e drejta të përzgjedh kandidatët. Konkursi, nëse do të pranohet, do të ishte forma më e mirë, por nëse do të pranohet konkursi si mënyrë për emërimin, nuk duhet të ketë të drejtë Prokurori i Përgjithshëm të përzgjedhë kandidatët sipas dëshirave, kuptohet politike. Kjo mënyrë emërimi, që përcaktohet në këtë projekt, do

të nxisë më tepër paaftësinë dhe politizimin e Prokurorisë.

5. Emërimi i drejtuesve të Prokurorisë i është lënë në kompetencë Prokurorit të Përgjithshëm (neni 9, pika c). Një praktikë e tillë jo vetëm që bie ndesh me praktikën e deritanishme, si dhe me praktikën e vendeve perëndimore, por kjo do të bëjë që të gjitha prokuroritë të jenë vegla të Prokurorit të Përgjithshëm.

6. Prokurorëve nuk u është njohur e drejta e ankimit për rastet e largimit të tyre nga puna. Mosnjohja e së drejtës së ankimit në këto raste bie në kundërshtim me Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut. E drejta e ankimit u njihet të gjithë punonjësve dhe gjykatësve. Mohimi i një të drejte të tillë përbën rrezik jo vetëm për prokurorët, por edhe për qytetarët, pasi prokurorët, duke mos pasur të drejtë mbrojtjeje do të sillen në mënyrë arbitrare me qytetarët, duke zbatuar në mënyrë të verbër urdhrat e Prokurorit të Përgjithshëm.

7. Nenet 54, 55 e 56 përcaktojnë raportet e Prokurorisë me Kuvendin e Republikës, Qeverinë dhe Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Nuk del e qartë se kujt do t'i japë llogari ky organ për përmbushjen e detyrave të tij. Nëse është organ i pavarur, atëherë ai nuk mund të zbatojë rekomandimet e Qeverisë siç përcaktohet në projekt. Nëse do të jetë një organ i varur, siç është në fakt, të përcaktohet varësia e tij me qëllim që të nxirret përgjegjësia politike për veprimtarinë e tij.

Miratimi i këtij projektligji do të sjellë shumë pasoja negative në veprimtarinë praktike të Prokurorisë. Të gjithë prokurorët tani do të kthehen në vegla të bindura të Prokurorit të Përgjithshëm. Ata janë të detyruar të zbatojnë urdhrat politike të Prokurorit të Përgjithshëm dhe jo ligjet. Ato nuk kanë asnjë pavarësi në veprimtarinë e tyre. Nëse do t'i referohemi parimeve mbi të cilat ngrihet Prokuroria, pra pjesës së parë, do të vërejmë, se nuk ekziston parimi i pavarësisë së prokurorit. Kjo natyrisht është bërë në mënyrë të qëllimshme, por që do të ketë pasojë të rëndë për veprimtarinë e prokurorëve. Centralizimi i Prokurorisë në dorën e Prokurorit të Përgjithshëm do të pengojë veprimtarinë e ligjshme të prokurorëve të

niveleve më të ulëta. Pasojat e këtij ligji do të ndjehen dukshëm në të gjithë veprimtarinë e shtetit. Me këtë ligj shteti juridik dhe demokracia janë të rrezikuara. Veprimtaria praktike e zbatimit të këtij ligji do të ndihmojë montimin juridik të një diktature të re.

Projektligji është përgatitur nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Ministria e Drejtësisë. Kjo del nga relacioni bashkëlidhur. Nëse do të shprehemi qartë, projekti është përgatitur nga Prokurori i Përgjithshëm, i cili i ka caktuar kompetenca të plota vetes, për të kontrolluar të gjithë Prokurorinë. Nëse do të ishte marrë parasysh mendimi i prokurorive më të ulëta, mendoj se projekti nuk do të ishte i tillë. Pra, mendoj se projekti duhej t'i nënshtrohej një diskutimi të gjerë publik për vetë rëndësinë që ka ky ligj. Gjithashtu, ishte e domosdoshme që projekti të përgatitej në bashkëpunim me ekspertë të huaj, sidomos të Këshillit të Europës. Nëse do të ishte marrë mendimi i ekspertëve të huaj përendimorë, ata nuk do të lejonin të përgatitej një projekt i tillë. Këshilli i Europës, me rastin e pranimit të Shqipërisë në këtë Këshill, është shprehur për reformën e Prokurorisë sipas standardeve përendimore, duke kritikuar përvojën e Prokurorisë së Përgjithshme. Në përgatitjen e këtij projekti nuk janë marrë parasysh sugjerimet e Këshillit të Europës.

Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend

Kjo rubrikë synon dhënie e një informacioni mbi legjislacionin e miratuar rishtazi, duke patur parasysh se njohja fillestare e legjislacionit përbën një nga elementet vitale të një shoqërie demokratike. Lidhja midis qytetarëve dhe qeverisë së tyre është e fortë vetëm atëhere kur shqetësimet e tyre, pra, të publikut pasqyrohen në legjislacionin përkatës. Qytetarët që e konsiderojnë qeverinë e tyre si legjitime, ka më shumë të ngjarë që t'i binden edhe ligjeve të saj. Në të njëjtën kohë, synohet t'i vihet në ndihmë subjekteve publike dhe private që “konsumojnë” ligje për një kuptim të shpejtë dhe objektiv të legjislacionit të miratuara rishtazi në Kuvend.

1. Ligji nr.8674, datë 26.10.2000 “Për ratifikimin e AMENDAMENTIT të Termave të përgjithshme të 7 marsit 1994”, nënshkruar ndërmjet Komitetit Qeveritar për Borxhin e Jashtëm dhe Oesterreichische Kontrollbank, AG

Objekti i Amendamentit është shtyrja e detyrimeve të borxhit mbi bazën e Termave të Referencës për Riorganizimin e Borxhit të Republikës së Shqipërisë të tetorit 1999. Ky Amendament është pjesë e pandarë e Termave të Përgjithshme të 7 marsit 1994, klauzolat e të cilave mbeten në fuqi të plotë, pasi nuk ndryshohen dhe nuk preken nga ky Amendament. Borxhet për të cilat do të zbatohet shtyrja janë: 100 për qind të shumave të principalit dhe të interesit (përfshirë interes-vonesat) që duheshin paguar deri më 31 mars 1999 dhe që nuk janë paguar dhe 100 për qind e shumave të principalit dhe interesit (pa interes-vonesat) që duheshin paguar nga 1 prilli 1999 deri

në 30 qershor 2000 (përfshirë) dhe që nuk janë paguar, të cilat rrjedhin nga llogaria e Marrëveshjes së Kredisë së 7 marsit 1994. Monedha e Marrëveshjes së Kredisë është EURO. Shuma e përgjithshme e detyrimeve të shtyra nuk do t'i kalojë 2 100 000 EURO dhe pagesa e shumave të shtyra do të bëhet në 10 këste të barabarta gjashtëmujore.

Ligji ka 2 nene dhe i bashkëlidhet Amendamenti. Ai ka hyrë në fuqi më 24.11.2000.

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.34, faqe 1671.

2. Ligji nr.8675, datë 26.10.2000 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Bankës Norvegjeze “Eksportfinans””

Korporata Elektro-Energjetike Shqiptare (KESH) më 19 gusht 2000 ka lidhur një kontratë për blerjen nga Jahobsen Elektro të disa nënstacioneve dhe materialeve të tjera. Banka Norvegjeze “Eksportfinans” i ka shprehur dëshirën Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë të bëjë financimin për këtë blerje, prandaj më 11 shtator 2000 lidhet një marrëveshje huaje midis Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Bankës Norvegjeze “Eksportfinans”. Kjo e fundit ka pranuar që Huamarrësit (Qeverisë së Republikës të Shqipërisë) t'i bëhet një lehtësi për rihuadhënien e këtij financimi KESH-it. Në Marrëveshje është parashikuar që huaja do të shtyhet në 20 këste të barabarta gjashtëmujore, duke filluar kësti i parë 6 muaj pas datës së konsolidimit. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin, palët kanë rënë dakord që ata t'i drejtohen Gjykatës së Arbitrazhit në Stohkolm, në përputhje me rregullat e Institutit të Arbitrazhit në Dhomën e Tregtisë së Stokholmit.

Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 26.11.2000.

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.35 faqe 1727.

3. Ligji nr.8676, datë 31.10.2000 “Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 1999”

Miratimi i Buxhetit faktik është detyrim ligjor që buron nga ligji nr.8379,

datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” Në përputhje me ligjin e lartpërmendur, Buxheti faktik i vitit 1999 paraqitet i shkëputur nga ligji vjetor i Buxhetit për vitin e ardhshëm. Ligji nr.8676, datë 31.10.2000 paraqet të dhëna për të ardhurat dhe shpenzimet e Buxhetit të Shtetit, buxhetit të sigurimeve shoqërore dhe buxhetit të sigurimeve shëndetësore, si dhe të dhëna për deficitin e përgjithshëm të shtetit dhe burimet e tij të financimit.

Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 24.11.2000.

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.34, faqe 1673.

4. Ligji nr.8677, datë 2.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”

Organizimi dhe funksionimi i policisë gjyqësore mbështetet në dispozitat e Kushtetutës, të Kodit të Procedurës Penale, të Kodit Penal dhe të ligjit nr.8677, datë 2.11.2000. Parashikimet në këtë ligj janë në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale për pjesët që flasin për policinë gjyqësore. Parimet bazë që përkufizojnë funksionimin, organet, personelin, varësinë nga gjyqësori të policisë gjyqësore janë pjesë e Kodit të Procedurës Penale. Pra, ligji i lartpërmendur është plotësues dhe ka për qëllim identifikimin e strukturës organizative dhe statusin e policisë gjyqësore për të gjithë skemën e strukturimit të saj. Ligji përcakton rregullat e atribuimit të funksioneve të policisë gjyqësore, të funksionimit të shërbimeve dhe seksioneve të policisë gjyqësore. Gjithashtu, rregullon përgjegjësinë e oficerëve dhe agjentëve të policisë gjyqësore dhe procedimin disiplinor dhe shfuqizon dekretin nr.1188, datë 10.8.1995 “Për policinë gjyqësore”.

Ligji ka 19 nene dhe ka hyrë në fuqi më 10.12.2000, botuar në Fletoren Zyrtare nr.37, faqe 1798.

5. Ligji nr.8678, datë 2.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”

Ligji i lartpërmendur u miratua nga Kuvendi dhe, në zbatim të pikës 1 të

nenit 84 të Kushtetutës, iu dërgua për shpallje Presidentit të Republikës. Bazuar në pikën 1 të nenit 85 të Kushtetutës, Presidenti ia ka kthyer ligjin Kuvendit për rishqyrtim. Deri më sot Kuvendi nuk e ka shqyrtuar dekretin e Presidentit për kthimin e ligjit.

6. Ligji nr.8679, datë 2.11.2000 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7962, datë 13.7.1995 “Për energjinë elektrike”

I gjithë ndryshimi bëhet në nenin 13 të ligjit ekzistues. Kështu në titullin e nenit 13 dhe në paragrafin e parë shkronja “b”, fjala “të përtëritshme” zëvendësohet me fjalën “të rinovueshme”. Në fund të shkronjës “b” shtohet një paragraf i cili përcakton se cilat janë burime të rinovueshme, duke numëruar të tilla p.sh.: energjinë diellore në të gjitha aplikimet e saj, energjinë e erës, energjinë hidrike etj. Pas paragrafit të katër shtohet një paragraf i ri me 3 pika, të cilat vendosin detyrimin që, duke filluar nga 1 janari, furnizuesi dhe prodhuesit e pavarur të energjisë elektrike mbi 2 MW, janë të detyruar të prodhojnë, për sistemin elektroenergjitik shqiptar, energji elektrike nga burime të energjive të rinovueshme, në masën 2 për qind të të gjithë sasisë së energjisë elektrike të prodhuar prej tyre nga burime të tjera. Detyrimi vlerësohet i plotësuar dhe duke blerë kuotën e njëvlefshme të energjisë elektrike nga prodhues të tjerë vendos ose duke e importuar. Ligji për mosplotësim të këtij detyrimi parashikon gjobë në masën 50-100 për qind të vlerës së këtij detyrimi, si dhe sanksione të tjera të cilat vendosen nga Enti Rregullator i sektorit të Energjisë Elektrike.

Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 9.12.2000

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.37, faqe 1807.

7. Ligji nr.8680, datë 2.11.2000 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së selisë Qendrore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq”

Me këtë ligji Qeveria e Republikës së Shqipërisë i njuh Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK) personalitetin juridik. Pra, KNKK-

ja gëzon në territorin e Republikës së Shqipërisë të drejtën e plotë për të lidhur kontratë, për të fituar dhe zotëruar pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe të ngrejë padi. Marrëveshja rregullon problemin e imunitetit të KNKK-së, të pronave dhe të pasurive të tij, të arkivave etj. Gjithashtu, në marrëveshje rregullohen probleme të mjeteve financiare, të përjashtimit nga taksat e drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta, nga taskat doganore etj. Parashikime bëhen edhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, arbitrazhin, ndryshimet në marrëveshje, marrëveshjet plotësuese etj.

Ligji ka 2 nene, kurse Marrëveshja ka 21 nene.

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.38, faqe 1813.

8. Ligji nr.8681, datë 2.11.2000 “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”

Ky ligj ndërton kuadrin bazë ligjor dhe institucional, nga i cili do të rrjedhë i gjithë dokumentacioni i nevojshëm që rregullon procesin e projektimit, ndërtimit, shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së digave e dambave. Pasuritë natyrore të vendit tonë kanë krijuar mundësinë që të ndërtohen rreth 630 diga, nga të cilat 306 plotësojnë kushtet e Komisionit Ndërkombëtar të Digave të Mëdha (ICOLD). Në këtë komision vendi ynë është anëtar qysh nga viti 1964. Ndërmjet 80 vendeve anëtare të ICOLD-it, vendi ynë renditet i 18-ti për nga numri i digave të mëdha të ndërtuara. Në saje të këtyre digave janë arritur vlera ekonomike të rëndësishme për prodhimin e energjisë elektrike, vaditjen, prodhimin e peshkut, transportin etj. Gjithë kjo pasuri kërkon një nivel cilësor projektimi e ndërtimi dhe ligji i miratuar është një mbështetje ligjore në këtë drejtim, aq më shumë që do t'i hapet rruga miratimit të një sërë aktesh nënligjore. Gjithashtu, i rëndësishëm në këtë ligj është edhe fakti i krijimit të Inspektoriatit Teknik të Diga/Damave si një element i ri, i cili do të ushtrojë kontroll të vazhdueshëm gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit të tyre dhe do të jetë një burim i saktë të dhënash. Kjo do të sjellë një shfrytëzim më të plotë e cilësor të pasurive natyrore të vendit.

Ligji ka 14 nene dhe ka hyrë në fuqi më 26.12.2000.

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.38, faqe 1819.

9. Ligji nr.8682, datë 7.11.2000 “Për një ndryshim në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, ndryshuar me ligjin nr.8501, datë 16.6.1999.

Në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, neni 51 është ndryshuar tërësisht. Ky ndryshim është bërë me ligjin nr.8501, datë 16.6.1999. Sipas nenit 51 të riformuluar, personi fizik dhe juridik, përpara marrjes të lejës së ndërtimit duhet të paguajë 1 për qind të vlerës së investimit që do të kryejë sipas preventivit të objektit. Ky fond depozitohet për llogari të financimit të studimeve urbanistike në pushtetin vendor. Gjithashtu, duhet të paguajë lidhur me shfrytëzimin e rrjetit inxhinierik ekzistues të ujësjellësit, kanalizimeve, elektrikut, telefonisë, rrugëve etj. Masa e pagesës është 1 për qind e vlerës së investimit sipas preventivit. Edhe ky fond përdoret për rikonstrukcionin e mjeteve të infrastrukturës nga organet e pushtetit vendor. Me ligjin nr.8682, datë 7.11.2000, në nenin 51 shtohet një paragraf. Sipas këtij paragrafi, komunat që kryejnë investime me fondet e FZSHH-së përjashtohen nga pagesa e 1 për qind e vlerës së investimit sipas preventivit të objektit për llogari të financimit të studimeve urbanistike të pushtetit vendor dhe 1 për qind për rikonstrukcionin e mjeteve të infrastrukturës nga organet e pushtetit vendor.

Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 9.12.2000.

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.37, faqe 1808.

10. Ligji nr.8683, datë 7.11.2000 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.6, datë 31.10.2000 “Për përballimin e gjendjes hidroenergjetike në vend”

Me aktin normativ, me fuqinë e ligjit, nr.6, datë 31.10.2000 të miratuar me ligjin e lartpërmendur, Koorporatës Elektroenergjetike Shqiptare, sh.a., për përballimin e situatës emergjente hidroenergjetike në vend, i shtohen 1 400 000 000 lekë për importimin e energjisë elektrike. Akti normativ ka gjetur edhe mënyrën e përballimit të këtij fondi dhe ka autorizuar KESH sh.a. të zgjidhë detyrimet e prapambetura me shtetet ose kompanitë e huaja,

duke i dhënë të drejtën të kryejë konvertimin dhe shlyerjen e detyrimit për energjinë në detyrim monetar. KESH-i ngarkohet të raportojë periodikisht në sistemin e thesarit në Ministrinë e Financave në lidhje me përdorimin e shumës së dhënë.

Ligji ka një nen dhe akti normativ me fuqinë e ligjit i bashkëngjitet ligjit nr.8683, datë 7.11.2000.

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.35, faqe 1737.

11. Ligji nr.8684, datë 9.11.2000 “Për disa shtesa në ligjin nr.8455, datë 4.2.1999 “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve që humbasin jetën në përmbushje të detyrës gjatë fluturimit”

Me ligjin nr.8455, datë 4.2.1999 familjet e pilotëve që humbasin jetën në përmbushje të detyrës gjatë fluturimit kanë një trajtim të veçantë. Me ligjin nr.8684, datë 9.11.2000, ky trajtim i veçantë shtrihet edhe mbi familjet e ekipit të ndihmës së shpejtë mjekësore, që për shkak të detyrës, gjatë fluturimit humbasin jetën. Në numrin e përfituesve futen edhe pilotët e njësisë së helikopterëve të Ministrisë së Shëndetësisë. Trajtimi i veçantë që jepet edhe për pjesëtarët e ekipit të ndihmës së shpejtë mjekësore ka të bëjë me masën e pensionit familjar, me shpërblimin e menjëhershëm, me garantimin e bursës e të së drejtës së studimit të fëmijëve të atyre që humbasin jetën, si dhe me të drejta të tjera. Në mënyrë të veçantë, ky ligj i shtrin efektet e tij edhe për familjet e pjesëtarëve të ekipit mjekësor dhe të pedagogëve të rënë në krye të detyrës në aksidentin ajror të Llogarasë në vitin 1989.

Ligji ka 7 nene dhe ka hyrë në fuqi më 16.12.2000.

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.38, faqe 1825.

12. Ligji nr.8685, datë 9.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”

Sipas ligjit të lartpërmendur, trajtohen me përfitim punonjësit që kanë punuar në miniera për një periudhë jo më pak se 11 vjet e gjysmë në nëntokë

dhe kanë një periudhë sigurimi jo më pak se 23 vjet, në rastet kur nuk ushtrojnë veprimtari ekonomike. Përfshihen nga përfitimet, sipas këtij ligji, personat të cilët përfitojnë të ardhura nga skema e sigurimeve shoqërore. Masa e përfitimit për punonjësit që u përmendën në paragrafin e parë (ose neni 2 i ligjit) do të jetë e barabartë me 60 për qind të bazës së vlerësuar. Me termin bazë e vlerësuar do të kuptohet paga sipas së cilës janë derdhur kontributet për sigurimet shoqërore nga data 1.1.1994 e deri në çastin e lindjes së të drejtës për përfitim. Në rastet kur për llogaritjen e bazës së vlerësuar mungojnë dokumentet, masa e përfitimit do të caktohet në nivelin e përfitimit minimal, i cili përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Kërkesa për përfitime paraqitet pranë degëve të agjencive të drejtorive rajonale të sigurimeve shoqërore vetëm nga subjektet që përfitojnë deri më datën 31.3.2001.

Ligji ka 7 nene dhe ka hyrë në fuqi më 16.12.2000.

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.38, faqe 1826.

13. Ligji nr.8686, datë 9.11.2000 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr.5, datë 6.10.2000 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”

Akti normativ nr.5, datë 6.10.2000 bën një shtesë në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” dhe konkretisht shtesa bëhet në nenin 26. Pas pikës 2 të këtij neni shtohet pika 2/1, sipas të cilës për importimin e makinerive dhe të pajisjeve, të bëra nga KESH sh.a, zbatohet sistemi i shtyrjes së pagës së TVSH-së. KESH sh.a. nuk paguan TVSH në doganë në çastin e importimit të këtyre makinerive dhe pajisjeve. Në deklaratën mujore të TVSH-së, që paraqitet në degën e tatimeve, TVSH-ja e makinerive dhe e pajisjeve të importuara raportohet si detyrim dhe si e zbritshme. Dogana merr një kopje të faturës së TVSH-së për të mbyllur llogaritë kontabile të importimeve.

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.38, faqe 1828.

14. Ligji nr.8687, datë 9.11.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Europiane të Arbitrazhit”.

Konventa Europiane për Arbitrazhin Tregtar Ndërkombëtar ka hyrë në fuqi më 7 janar 1964, me qëllimin që të kontribuojë në zhvillimin e tregtisë europiane, të mënjanohej sa të jetë e mundur disa vështirësi, të cilat mund të pengojnë organizimin dhe funksionimin e Arbitrazhit Tregtar Ndërkombëtar në marrëdhëniet midis personave fizikë ose juridikë të vendeve të ndryshme të Europës. Konventa Europiane mbi Arbitrazhin Ndërkombëtar në përmbajtjen e saj ka fushën e zbatimit, organizimin e arbitrazhit, rastet e kundërshtimit mbi kompetencën e arbitrazhit, juridiksionin e gjykatës së arbitrazhit, rastet e anulimit të vendimit të arbitrazhit etj.

Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 16.12.2000.

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.38, faqe 1829.

15. Ligji nr.8688, datë 9.11.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit”

Konventa për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit zbatohet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit, që janë në territorin e një shteti të ndryshëm prej atij ku kërkohen njohja dhe ekzekutimi i vendimeve, dhe që u përkasin marrëveshjeve midis personave fizikë ose juridikë. Ajo zbatohet gjithashtu për vendimet e arbitrazhit që nuk konsiderohen si vendime të arbitrazhit në shtetin ku kërkohet dhe ekzekutimi i tyre. Dispozitat e kësaj Konvente nuk prekin vlefshmërinë e marrëveshjeve shumëpalëshe ose dypalëshe, që lidhen me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit që kanë hyrë në fuqi midis shteteve kontraktuese. Çdo shtet kontraktues mund të denoncojë këtë Konventë, duke njoftuar me shkrim Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Denoncimi do të sjellë efektet një vit pas datës kur Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara do të ketë marrë njoftim.

Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 16.12.2000.

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.38, faqe 1836.

16. Ligji nr.8689 “Për parandalimin e përhapjes së infeksionit HIV/AIDS në Republikën e Shqipërisë.

Me ligjin e lartpërmendur synohet të bëhet një punë më e organizuar dhe me përgjegjësi, që të sëmurët dhe sieropozitivët të gjejnë mbështetje nga shteti dhe shoqëria. Ai përcakton detyrimet e të drejtat që kanë shtetasit e Republikës së Shqipërisë që janë të infektuar, por edhe detyrimet e të drejtat e shtetasve të huaj të infektuar që ndodhen në territorin e vendit tonë. Ligji rregullon problemet që lidhen me sigurimin e informacionit të rregullt për popullsinë, për masat parandaluese, për mbikëqyrjen epidemiologjike, diagnostikimin dhe ekzaminimet laboratorike falas, ruajtjen e anonimatit, trajtimin e këshillimin e personave në qendrat e kualifikuara mjekësore etj. Në kapitujt e veçantë të ligjit flitet për rolin e institucioneve shtetërore, për parimet e ndihmës mjekësore, për të drejtën e informimit të personit të infektuar me HIV, për mbështetjen shoqërore për personat e infektuar me HIV etj. Ana më humane e ligjit duket sidomos në kreun V ku përcaktohet mbështetja financiare (pension ose ndihmë sociale) për të paaftët, lehtësi për shërbime mjekësore, udhëtime falas, përparësi në dhënie kredish për përmirësimin e kushteve të banimit etj. Gjithashtu, ligji parashikon edhe dëmshpërblime ose ndjekje penale për personat që infektojnë të tjerët nga pakujdesia në detyrë ose me dashje. Marrëveshjet ndërkombëtare, veçanërisht me OBSH-në, etj., marrin përparësi mbi rregullat e parashikuara në këtë ligj.

Ligji ka 28 nene dhe ka hyrë në fuqi më 30.12.2000.

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.40, faqe 1897.

17. Ligji nr.8690, datë 16.11.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën “Për mbrojtjen e mjedisit detar dhe të zonës bregdetare të Detit Mesdhe, si dhe të 6 protokolleve shoqëruese”.

Konventa parashikon marrjen e masave parandaluese, kryerjen e vlerësimit të ndikimit në mjedis për të gjitha veprimtaritë që mund të zhvillohen në det ose në tokë, ushtrimin e liçencimit për të gjitha veprimtaritë

e sipërpërmendura, zbatimin e parimit “ndotësi paguan”, nxitjen e manaxhimit të integruar të zonës bregdetare, nxitjen e zbatimit të teknologjive më të mira të mundshme, të praktikave më të mira mjekësore dhe të teknologjive të prodhimit të pastër e ndalimin e djegies në det. Gjithashtu, Konventa parashikon forcimin e masave për mbrojtjen e mjedisit detar nga fundosjet e anijeve, në përputhje me legjislacionin botëror përkatës, hartimin e planeve për zbutjen e ndotjes nga të gjitha burimet e ndotjes të vendosura në tokë, si dhe monitorimin e detyruar të shkarkimeve të ndryshme nga këto burime, ndërtimin e programeve për monitorimin e ndotjes së Detit Mesdhe dhe të zonës bregdetare, bashkëpunimin në fushën e kërkimit shkencor dhe teknologjik dhe të legjislacionit mjedisor, si dhe rritjen e rolit të publikut dhe të OJQ-ve në vendimmarrjen për problemet e mjedisit, për të dhënat për gjendjen e tij dhe për planet e veprimit. Konventa dhe protokollat përkatëse përbëjnë një veçori, sepse bëhet fjalë për një marrëveshje rajonale me specifikat dhe përfitimet rajonale përkatëse, prandaj aderimi në këtë Konventë ka një rëndësi të veçantë për vendin tonë.

Ligji ka 3 nene dhe ka hyrë në fuqi më 28.12.2000.

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.43, faqe 1935.

NJË VËSHTRIM I SHKURTËR PËR KONTROLLIN KUSHTETUES

Sokol Sadushi

*Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese
të Republikës së Shqipërisë*

Studimet teorike për kontrollin kushtetues, si një ndër elementet më të rëndësishme në shkencën e së drejtës kushtetuese përkohë me fillimin e shekullit XX. Nevoja për ekzistencën e një kontrolli të karakterit kushtetues ndaj veprimtarisë së organeve që përfaqësojnë pushtetet në fushën e nxjerrjes së akteve juridike, ushtrimi në mënyrë normale dhe pa ndërhyrje i të drejtave dhe detyrave të secilit organ në pushtetet përkatëse, zgjidhja ligjore e mosmarrëveshjeve të kompetencave ndërmjet organeve që përfaqësojnë këto pushtete, mbrojtja dhe respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të individëve, si rrjedhojë e dhunimit dhe e shkeljeve flagrante që u bëhej atyre, si dhe domosdoshmëria e mbrojtjes dhe e respektimit të Kushtetutës, kanë ndikuar për krijimin e një organi të lartë me natyrë kushtetuese. Krijimi, së pari, në Austri i së parës gjykatë kushtetuese, që do të kryente këtë rol të rëndësishëm, e konsolidoi kontrollin kushtetues, i cili aktualisht ka krijuar mjaft qartë fizionominë e tij, në pjesën më të madhe të shteteve të ndryshme.

Kontrolli kushtetues kërkon procedura të ndryshme gjykimi, te të cilat ndikojnë çaste të ndryshme që kanë të bëjnë: *me inicimin e gjykimit* për të vënë në lëvizje gjykatën kushtetuese, *me afatin e paraqitjes së kërkesës, mënyrën e paraqitjes së kërkesave, kohën, shterimin e mjeteve të tjera ligjore të kërkuara, natyrën e rëndësishme të çështjes, barrën e të provuarit, përmbajtjen dhe efektet e vendimeve të dhëna nga gjykata, mënyrën dhe kohën e shpalljes së tyre, fuqinë juridike, pasojat* që ato krijojnë etj.

Është e rëndësishme të bëhet një dallim i qartë, në çdo rast, për çështjet kushtetuese, të cilat ngrihen si çështje të një kontrolli paraprak, nga ato çështje që në teori njihen si çështje të kontrollit represiv të normave. Gjithashtu, dhe këto të fundit përmbajnë në vetvete dallimet e tyre që shfaqen në rishikimin abstrakt të dispozitave ligjore nga ai konkret i tyre.

Sfera e juridiksionit të gjykatave kushtetuese ka shkuar si drejt zgjerimit, ashtu dhe ngushtimit. Juridiksioni kushtetues përfshin shumë aspekte të rëndësishme, duke filluar nga rishikimi i kushtetutshmërisë së ligjeve, zgjidhja e mosmarrëveshjeve të kompetencës ndërmjet pushteteve, çështje të kushtetutshmërisë së partive politike, zgjedhjet, mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të individëve etj. Megjithatë, pavarësisht nga larmia e çështjeve dhe problemeve është i nevojshëm trajtimi teorik i disa çështjeve kryesore me të cilat ndeshet vazhdimisht gjykata kushtetuese.

Kontrolli kushtetues i pajtueshmërisë së ligjeve me kushtetutën është aspekti ndoshta më i rëndësishëm dhe shprehja më e qartë e veprimtarisë që kryen gjykata kushtetuese, si garante e respektimit të kushtetutës. Format kryesore të këtij kontrolli janë kontrolli paraprak, ose siç quhet ndryshe, kontrolli *a priori*, dhe kontrolli represiv ose kontrolli *a posteriori* i normës.

Kontrolli paraprak, sipas *legjislacionit të shteteve europiane, nënkupton kontrollin mbi normën juridike të kryer nga gjykata kushtetuese, ku përfshihen kontrolli ndaj ligjeve, akteve të tjera normative, marrëveshjeve ndërkombëtare, çështjeve të shtruara për referendum, dekretligjeve, ordonancave rajonale ligjvënëse etj., përpara se këto akte të miratohen nga organi konkret ose të shpallen.*

Sipas neneve 131, shkronja b dhe 152, pika 1 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, kontrolli paraprak është i kufizuar vetëm në dy drejtime: ndaj marrëveshjeve ndërkombëtare dhe çështjeve që shtrohen për referendum.

Marrëveshjet ndërkombëtare, sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, radhiten në hierarkinë e normave menjëherë pas Kushtetutës. Nisur nga pozicioni që marrëveshjet ndërkombëtare zënë në raport me aktet

e tjera, që ato të jenë në përputhje me parimet që sanksionon Kushtetuta dhe, duke vlerësuar faktin se këto marrëveshje pasi ratifikohen bëhen të detyrueshme, është parashikuar në nenin 131 shkronja b dhe në nenin 52 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin e funksionimin e Gjykses Kushtetuese” e drejta e Gjykses Kushtetuese që të vendosë për pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën, para ratifikimit të tyre.

Rishikimi paraprak që kryen Gjysekata Kushtetuese i shërben shmangies së dispozitave antikushtetuese që mund të përmbajë marrëveshja ndërkombëtare, e cila pritet të ratifikohet. Nëse Gjysekata Kushtetuese e gjen të papajtueshme me Kushtetutën marrëveshjen ndërkombëtare në përgjithësi, ose elemente të veçanta të saj, atëherë vendimi i saj, i dërgohet Kuvendit, i cili është i detyruar ta zbatojë.

Rishikimi paraprak kryhet nga Gjysekata Kushtetuese edhe gjatë shqyrtimit të kushtetutshmërisë së çështjeve të shtruara për referendum, sipas nenit 150, paragrafi 1 e 2, nenit 151, paragrafët 2 e 3 dhe nenit 177, paragrafët 4 e 5 të Kushtetutës. Gjysekata Kushtetuese, nëpërmjet kontrollit paraprak, vlerëson vetëm kushtetutshmërinë e çështjeve të shtruara në referendum, por në asnjë rast rëndësinë e tyre. Ajo shqyrton kushtetutshmërinë e referendumit brenda një afati prej 60 ditësh, afat i cili duhet detyrimisht të respektohet nga Gjysekata Kushtetuese. Përndryshe, çfarëdo lloj vendimi që ajo mund të marrë tej këtij afati, nuk ka më fuqinë e një vendimi të detyrueshëm.

Për të vënë në lëvizje Gjyksesatën Kushtetuese për shqyrtimin e këtyre çështjeve duhet të ekzistojë e drejta e një subjekti konkret, pasi Kushtetuta nuk ia njuh kësaj Gjyksesate të drejtën e nismës. E drejta për të iniciuar një çështje të kontrollit paraprak u përket një numri të kufizuar subjektesh, sipas nenit 134 të Kushtetutës dhe nenit 52 pika 2 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin e funksionimin e Gjyksesatës Kushtetuese”. Dhe kjo është e kuptueshme, pasi jo çdokush dhe jo në çdo fazë të procesit ligjvënës ose të çdo lloj procesi tjetër mund t’i drejtohet Gjyksesatës

Kushtetuese për të kërkuar paraprakisht që ajo të vendosë për pajtueshmërinë me Kushtetutën të një marrëveshje ndërkombëtare ose dhe të një çështjeje që do të shtrohet për referendum.

Kontrolli kushtetues i pajtueshmërisë së ligjeve dhe akteve të tjera normative me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare është një formë e kontrollit *a posteriori*. Ky kontroll, në dallim nga kontrolli *a priori* është i zbatueshëm për ato akte ligjore, të cilat janë nxjerrë dhe kanë marrë fuqinë e tyre juridike. Kjo njihet si formë represive në rishikimin e normës, për arsye se ajo nuk ka ndonjë karakter rekomandues ndaj organeve që kanë nxjerrë një akt të tillë, pasi, nëse normën juridike - objekt kontrolli, Gjykata Kushtetuese e gjen të papajtueshme me Kushtetutën, ajo e shfuqizon atë.

Kontrolli kushtetues i normës në doktrinë paraqitet në dy format e tij kryesore: kontrolli abstrakt dhe ai konkret. Kontrolli abstrakt, i njohur si rishikim i drejtpërdrejtë, duke iu referuar Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë (neni 131 shkronja “a” dhe “c”), shtrihet ndaj ligjeve, akteve normative të organeve të qeverisjes qendrore dhe atyre vendore. Ai është i lidhur vetëm me çështje të kushtetutshmërisë së normave të cilat atakohen. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese në këto raste merr efektet juridike erga omnes, pra për të gjithë. Në këtë kuptim ai paraqitet si një gjykim abstrakt.

Gjykata Kushtetuese gjatë shqyrtimit të këtyre çështjeve vlerëson përmbajtjen, formën, procedurën e miratimit, shpalljen dhe hyrjen në fuqi të ligjeve e të akteve normative. Përrjashtim nga kontrolli kushtetues nuk bëjnë as kategori të caktuara të ligjeve, siç janë ligjet që nxirren në periudha emergjente, fatkeqësie natyrore ose gjendjeje të jashtëzakonshme. Këto ligje, pavarësisht nga çasti ose rrethanat që ndikojnë në nxjerrjen e tyre, do të konsiderohen njëlloj si ligjet e tjera dhe me fuqi të njëjtë juridike në hierarkinë e normave.

Në vendet që miratojnë një kushtetutë të re, ligjet e hartuara që datojnë në kohë përpara hyrjes në fuqi të kushtetutës dhe bien në kundërshtim me të, i nënshtrohen, gjithashtu, këtij kontrolli. Kjo është e kuptueshme, pasi ligjet e mëparshme nuk mund të vazhdojnë të zbatohen sa kohë që ato nuk

i përmbahen kushtetutës së re. Për rrjedhojë, ato do t'i nënshtrohen procedurave ligjvënëse, duke u zëvendësuar me ligje të reja ose do të shfuqizohen nga Gjykata Kushtetuese. Ky është kuptimi i nenit 178 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas të cilit ligjet e hartuara përpara miratimit të kushtetutës së re do të konsiderohen të zbatueshme derisa ato të shfuqizohen. Kjo është e lidhur me të drejtën e Gjykatës Kushtetuese për t'ia nënshtuar përmbajtjen e këtyre ligjeve rishikimit kushtetues.

Njihet nga kushtetutat e disa shteteve edhe kontrolli kushtetues i ligjeve, të cilët amendojnë kushtetutën, si dhe rishikimi i dispozitave bazë të saj. Sipas kushtetutave të disa vendeve si Rusia, Ukraina, Turqia, Qipro etj. rishikimit a posteriori u nënshtrohen edhe dispozitat kushtetuese dhe ligjet që amendojnë kushtetutën. Kjo formë kontrolli, e cila zbatohet në një numër të kufizuar shtetesh, duhet kryesisht të garantojë një ankim për anën formale të amendamenteve kushtetuese, duke e përjashtuar gjykatën nga shqyrtimi i kushtetutshmërisë së përmbajtjeve të tyre. Nuk do të ishte normale që Kushtetuta ose amendamentet që i bëhen asaj në dispozita konkrete, t'i nënshtrohen rishikimit abstrakt në përmbajtjen e tyre nga Gjykata Kushtetuese, pasi kjo formë kontrolli jo vetëm që nuk ka një përkrahje në doktrinë, por edhe në ato kushtetuta që ajo parashikohet, gjykata mund të vlerësojë vetëm anën procedurale të miratimit të një ligji amendues.

Kushtetuta jonë nuk e njuh këtë lloj kontrolli. Sipas nenit 152 dhe 177 të saj, Gjykata Kushtetuese mund ta ushtrojë kontrollin kushtetues lidhur me procedurën e miratimit në Kuvend të amendamenteve kushtetuese, vetëm nëse projektligji për rishikimin e Kushtetutës, pra amendamenti kushtetues, do t'i nënshtrohet për miratim referendumit popullor. Dhe ky kontroll kushtetues nuk është formë e rishikimit a posteriori, por është një kontroll paraprak, që i bëhet kushtetutshmërisë së çështjes të zhvillimit të referendumit dhe jo përmbajtjes së amendamentit kushtetues.

Doktrina kushtetuese njuh rishikimin abstrakt edhe ndaj akteve të Presidentit të Republikës. Kushtetuta jonë në këtë drejtim ka një ndryshim në krahasim me dispozitat e mëparshme kushtetuese, që njihite të drejtën e

Gjykatës Kushtetuese të shqyrtonte pajtueshmërinë e ligjeve dhe të akteve që kanë fuqinë e ligjit me Kushtetutën. Dekreti i Presidentit të Republikës i cili, sipas nenit 18 të këtyre dispozitave kushtetuese, në raste të ngutshme mund të kishte edhe karakter normativ, interpretohej me të drejtë si një akt që kishte fuqinë e ligjit dhe, nga ky këndvështrim, dekreti i nënshtrohej rishikimit abstrakt të Gjykatës Kushtetuese. Me Kushtetutën e sotme, Presidentit të Republikës nuk i njihet në mënyrë të shprehur e drejta e nxjerrjes së dekreteve me karakter normativ (përjashtim bëhet vetëm për raste lufte). Nisur nga ky qëndrim që mban Kushtetuta, dekreti i Presidentit nuk i nënshtrohet kontrollit abstrakt nga Gjykata Kushtetuese.

Ndryshe trajtohet çështja për individët të cilët, në bazë të nenit 131 shkronja “f” të Kushtetutës, pasi t’i jenë shterruar mjetet e tjera juridike për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese dhe për parregullsi në procesin ligjor, mund t’i drejtohen Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin qoftë edhe të dekretit të Presidentit, pasi ky gjykim në këtë rast nuk bën pjesë në rishikimin abstrakt të normës juridike.

Kontrolli konkret është një tjetër formë e kontrollit kushtetues *a posteriori* të ligjit, e cila inicohet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm gjatë shqyrtimit të një çështjeje ende të pazgjidhur, që varet nga ligji konkret dhe antikushtetutshmëria e të cilit vihet në dyshim nga ajo gjykatë. Kontrolli konkret nuk e lejon gjykatën e juridiksionit të zakonshëm të vendosë vetë për papajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën, pasi një e drejtë e tillë është e përqendruar në Gjykatën Kushtetuese. Këtu dallohet *sistemi i përqendruar* i rishikimit (parimi i kontinentit) nga *sistemi i shpërndarë* (karakteristikë e sistemit amerikan). Sipas këtij kontrolli, gjykata e zakonshme bëhet në këtë rast iniciuese për një proces kushtetues, lidhur me kushtetutshmërinë e ligjit, por ajo nuk paraqitet vetë në pozicionin procedural të një kërkuesi të zakonshëm. Gjykata mjaftohet të arrijë në përfundimin se kur një ligj, zbatimi i të cilit ka lidhje me përfundimin e çështjes, është antikushtetues, çështja të dërgohet në Gjykatën Kushtetuese. Ky lloj kontrolli rishikues konsiderohet si konkret, sepse ka të bëjë me një çështje të caktuar në gjykim, e cila nuk

mund të zgjidhet pa ushtruar Gjykata Kushtetuese këtë funksion rishikues. Kuptimi i dhënë në këtë dispozitë të Kushtetutës dhe në nenet 68, 69 dhe 70 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” përcaktojnë se ne kemi pranuar tashmë parimin e rishikimit të përqendruar, duke mos i dhënë të drejtën gjyqtarëve të gjykatave të zakonshme të shprehen vetë për kushtetushmërinë e ligjeve.

Rishikimi konkret, sipas Kushtetutës së sotme, në dallim nga Dispozitat Kryesore Kushtetuese, por dhe nga praktika e shumë gjykatave kushtetuese të Europës, ushtrohet vetëm ndaj ligjeve, duke e kufizuar shtrirjen e këtij kontrolli në aktet normative. Sipas kuptimit që Kushtetuta jonë i ka dhënë rishikimit konkret, aktet normative, që ndeshen jo rrallë gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjeve nga gjykatat e zakonshme, nuk mund të bëhen objekt kontrolli kushtetues me inicimin e gjykatave të zakonshme, por nga subjektet e tjera që parashikon nenin 134 i Kushtetutës, nëpërmjet rishikimit abstrakt.

Konrolli kushtetues mbetet një nga fushat kryesore të veprimtarisë së Gjykatës Kushtetuese, e cila kërkon pasjen e një kuptimi të drejtë dhe të qartë në radhë të parë nga subjektet që iniciojnë procesin kushtetues, për të cilët nuk paraqitet vetëm si një e drejtë e tyre për ta ushtruar, por njëkohësisht duhet kuptuar edhe si një detyrim, me qëllim që ligjet, të cilët përmbajnë antikushtetutshmëri, të mos i shmangen këtij kontrolli kushtetues.

PYETJET DHE INTERPELANCAT- MJET I RËNDËSISHËM I KONTROLLIT PARLAMENTAR

Viktor Gumi

Këshilltar Juridik në Kuvend

KONTEKSTI NDËRKOMBËTAR

Një nga mjetet e rëndësishme në ushtrimin e kontrollit parlamentar janë pyetjet dhe interpelancat, domethënë detyrimi i anëtarëve të kabinetit qeveritar për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe kërkesave të parlamentarëve, me gojë ose me shkrim. Në legjislacione të ndryshme shpesh gjejnë shprehje edhe afatet kohore brenda të cilave ministrat duhet t'u përgjigjen pyetjeve dhe interpelancave ose, në raste të veçanta, mund të kërkojnë shtyrjen e tyre për arsye taksative, kryesisht të shprehura në rregulloret për organizimin dhe funksionimin e parlamenteve. Këto afate kohore variojnë nga 6 ditë në Danimarkë dhe Norvegji, 7 ditë në Japoni, deri edhe në disa muaj si në Austri, për shembull, deri në 2 muaj. Bundestagu Gjerman ofron edhe një përvojë unike në këtë drejtim, ku kohët e fundit përherë e më tepër po zbatohet një procedurë sipas së cilës anëtarëve të qeverisë federale u parashtrihen pyetje me gojë për gati gjysmë ore menjëherë pas mbledhjes së Qeverisë Federale. Një përvojë e tillë është eksperimentuar në gati 43 raste në këtë legjislaturë të Bundestagut gjerman. Në shumë parlamente të botës janë krijuar organe të veçanta të kontrollit, veçanërisht në zbatimin e buxhetit dhe në veprimtarinë e administratës publike. Në ato vende ku Kontrolli i Lartë i Shtetit raporton në ekzekutiv, si për shembull në Suedi e Finlandë, kontrolli parlamentar historikisht ka luajtur një rol kyç në kontrollin e përdorimit të fondeve publike.

PËRMASAT KUSHTETUTORE TË PYETJEVE DHE INTERPELANCAVE DHE PËRKUFIZIMI I TYRE

Shtetasve në një shoqëri demokratike u shërbejnë disa lloj zyrtarësh publikë: legjislatorët, administratorët dhe punonjësit e ekzekutivit dhe gjyqtarët. Parlamentit i përkasin dy funksione kryesore, ai i drejtimit politik dhe i ligjbërjes; gjyqësorit - gjykimi i fakteve dhe i qëndrimeve që pretendohen se janë shkelje të drejtësisë ose të interesave të ligjshme që mbrohen nga shteti dhe ekzekutivi, i cili përfshin korpusin e sistemit të qeverisjes që nuk përfshihet në pushtetin ligjvënës dhe gjyqësor.

Në fakt, thelbi i mendimit kushtetutor shqiptar është mbështetja e një qeverie që bazohet në pëlqimin popullor, në ndarjen e pushteteve në rrugë kushtetuese dhe vendosjen e kufizimeve të shkruara për ata që kanë marrë përsipër të drejtojnë dhe manaxhojnë problemet e shtetasve. Kontrollat dhe baraspeshimet e brendshme kushtetutore, përgjithësisht, i shërbejnë qëllimit për të ndrequr dhe mbikëqyrur politikat e parregullta. Megjithatë, në fund të fundit, janë shtetasit ata që vendosin nëse janë lënë pas dore ose nuk janë kryer detyra të rëndësishme qeveritare ose nëse janë tejkaluar caqet kushtetuese nga ndonjë degë e veçantë e sistemit të qeverisjes. Në rast se nuk arrihet ky baraspeshim dhe ky kontroll, publiku me anë të kutisë së votimit largon ose kërcënon të largojë nga detyra nëpunësit zyrtarë që nuk zbatojnë, shpërdorojnë ose keqpërdorin funksionet e tyre.

Nën këtë këndvështrim merr rëndësi të madhe identifikimi i aspekteve të kontrollit parlamentar dhe sidomos shqyrtimi, analizimi dhe realizimi i njërës prej mjeteve më shprehëse të tij, pyetjet dhe interpelancat.

Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë ka përkufizuar *pyetjen* si kërkesë të deputetëve për të marrë informacion për një ose disa probleme të caktuara, ndërsa *interpelancën* si kërkesën me shkrim për të marrë shpjegime lidhur me motivet, synimet dhe qëndrimin e Këshillit të Ministrave, lidhur me aspekte të rëndësishme të veprimtarisë së tij. Kështu, këto mjete kontrolli, në emër të parimit të ndarjes dhe balancës së pushteteve, fokusohen natyrshëm në një element të thjeshtë:

kërkimin e të dhënave dhe qartësimin publik prej degës ekzekutive për një situatë ose fakt të caktuar. Karakteristikat e këtyre mjeteve të kontrollit janë, së *pari*, sepse janë mjete të frytshme për hapjen e një debati publik dhe sensibilizimin e shoqërisë, në lidhje me një problem të caktuar dhe, së *dyti*, passjell mbajtjen e një qëndrimi të caktuar i cili shpreh në vetvete refuzimin ose miratimin e parlamentit për qëndrimet e mbajtura nga qeveria (praktika e fundit nuk njihet nga legjislati shqiptar). Përaftrim me karakteristikën e *dytë*, përvoja shqiptare ofron mocionin për debat, i cili duhet të kërkohet nga të paktën 5 deputetë dhe të përfundojë me miratimin e një deklarate, rezolute ose vendimi të detyrueshëm për t' u zbatuar nga ana e ekzekutivit.

PYETJET DHE INTERPELANCAT NË PRAKTIKËN SHQIPTARE

Në përgjithësi, çështjet e ngritura në këtë dhjetëvjeçar kanë qenë të shumta, por pyetjet dhe interpelancat përfaqësojnë një nga çështjet më interesante në të drejtën parlamentare. Në çastet e deritanishme zor se mund të gjejmë një trajtim përfundimtar të tyre, sidomos për konceptin tonë të kufizuar nga përvoja e paktë, por gjithsesi të shpresojmë se mund të prekim shkarazi, duke paraqitur një kuadër që mbase do të mund të strukturonte në mënyrë të dobishme mendimin profesional dhe atë të lexuesit në këtë fushë.

Së *pari*, praktika e deritanishme e së drejtës parlamentare ka treguar se paraqet vështirësi identifikimi dhe dallimi i një seance pyetjesh me atë të një interpelance. Ashtu sikundër sot pranohet se këto janë dy instrumente politikisht thelbësore për jetën parlamentare dhe që shprehin në vetvete një nga elementet më të spikatura të statusit të deputetit, po ashtu është e rëndësishme dhe e domosdoshme të pranohet edhe zbatimi i rregullave formale për realizimin praktik të tyre. Sikundër e përmendëm edhe më lart, kërkesa për marrje informacioni për një çështje të caktuar përbën pyetjen, ndërsa shpjegimet për aspekte të rëndësishme të veprimtarisë së Këshillit të Ministrave përbëjnë interpelancën.

Së *dyti*, në disa raste në jetën parlamentare është bërë një interpretim i gabuar i nenit 80 pika 3 të Kushtetutës, nen i cili përcakton të drejtën e komisioneve

për të kërkuar shpjegime dhe informacion për çështje të ndryshme të institucioneve shtetërore përsa e lejon ligji. Për mendimin tim kjo pikë nuk duhet parë në asnjë mënyrë e shkëputur nga pjesa tjetër e nenit 80 dhe në tërësi nga qëllimi që ka pasur ligjvënësi në hartimin e këtij neni. Një dispozitë e tillë është e zbatueshme, përveç anëtarëve të kabinetit qeveritar, edhe në institucione të tilla që nuk kanë statusin e ministrit, por që barazohen me to. Problemi qëndron nëse komisioneve parlamentare u lind e drejta të kërkojnë informacion dhe shpjegime nga drejtues të organeve kushtetuese dhe, nëse po, cilat janë caqet e kësaj marrëdhënieje. Nëse një titullar institucioni thirret për të dhënë informacion në Kuvend, ky veprim qëndron brenda parimit të ndarjes dhe balancës së pushteteve dhe është zbatim i drejtpërdrejtë i përcaktimit kushtetues se Republika e Shqipërisë është republikë parlamentare. Por pozita e këtyre institucioneve nuk duhet barazuar në asnjë mënyrë me atë të ministrit dhe, për pasojë edhe informimi nuk duhet të kalojë në llogaridhënie. E shprehur më thjesht, nëse pa hezitim një ministri, kudo qoftë, në seance plenare ose komision, mund t' i shtrohet pyetja "PSE", kjo është e vetmja pyetje që nuk mund të shtrohet gjatë informimit të Kuvendit nga institucionet kushtetuese.

Së treti, ndoshta për një manaxhim më të mirë të kohës në parlament dhe efektivitet të punës së tij, do të ishte më mirë që seancat e pyetjeve dhe të interpelancave të përqendroheshin vetëm në një ditë të javës, gjithmonë duke respektuar afatin kohor të parashikuar në Kushtetutë. (Zbatimi i një praktike britanike, e cila përfshin edhe Kohën e Pyetjeve të së Martës në House of Commons, po kërkohet, ndonëse po has në shumë kundërshtime edhe nga Dhoma e Përfaqësuesve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.)

Së katërti, pyetjet dhe interpelancat janë një marrëdhënie e dyanshme ekzekutiv - ligjvënës dhe kjo marrëdhënie nuk duhet të fillojë dhe të mbarojë me zhvillimin e një seance plenare. Përkundrazi, duhet dyanshëm të ndiqen efektet e realizimit të këtij mjeti kontrolli, në mënyrë që të materializohen në praktike ato se për çfarë u tërhoq ose u sensibilizua opinioni publik. Transmetimi në mënyrë të plotë i pyetjeve dhe interpelancave nga Televizioni ynë publik,

zhvillimi me dyer të hapura i këtyre seancave përbën një faktor të rëndësishëm për vazhdimësinë e ndjekjes së problemeve deri në zgjidhjen përfundimtare të tyre.

Së pesti, në praktikë, sidomos në rastet e zhvillimit të interpelancave me debat ose në rastet e mocioneve për debat, mund të lindin vështirësi në zhvillimin e seancave plenare në rastet e zbatimit të nenit 80 pika 2 të Kushtetutës, sipas të cilit anëtarët e Këshillit të Ministrave marrin pjesë dhe flasin në çdo kohë e sa herë që ata kërkojnë fjalën. Për pasojë, mazhoranca, së cilës i përket edhe Qeveria, e ndjen veten tejmase të privilegjuar dhe i krijohen mundësira shprehëse pa fund, ndërsa opozitës i kufizohen ato nëpërmjet caktimit të kohës së diskutimeve. Zgjidhja tipike për këtë kundërshti është zgjidhja që ka paraqitur parlamenti gjerman, ku anëtarët e qeverisë dhe diskutantët e grupeve parlamentare që e mbështesin atë, fillimisht u caktohet një kohë maksimale në dispozicion për diskutime, e cila ndahet përpjesëtimisht. Formula kohore e cila zbatohet në Bundestag quhet “Bonner Stunde” (Bonn hour) dhe sipas saj në pak me tepër së një orë debat, Qeveria dhe diskutantët e opozitës kanë në dispozicion 36 minuta, ndërsa opozita ka në dispozicion 30 minuta, në të cilat 20 minuta i lihen grupit opozitar më të madh. Karakteristike në këtë debat është se Rregullat e Funkcionimit të Parlamentit Gjerman, në vijim të traditës së shekullit XIX, nuk i lejojnë deputetët të lexojnë në seancë plenare fjalime të parapërgatitura me shkrim. Natyrisht pyetjet dhe interpelancat nuk kanë një peshë shumë të madhe në punët parlamentare, por ky fakt nuk e bën aspak të lehtë trajtimin e tyre. Një shprehje thotë: “Rregullat janë bërë për t’u shkelur”. Rregullat, pashmangshmërisht krijojnë rrezikun e tensioneve. Ne nuk kemi një procedurë vendimmarrjeje të përpiktë, që t’i peshojë të gjithë faktorët e mundshëm që lidhen me çështjen në mënyrë mekanike, pra as edhe një përfundim të saktë pa kurrfarë mëdyshjesh. Në këto kushte më e shumta që mund të shpresojmë është që degët e pushtetit në ushtrim të të drejtave të tyre të jenë të ndjeshme ndaj vlerave dhe nevojave të shoqërisë.

KONTROLLI I PUSHTETIT LIGJVËNËS NDAJ ORGANEVE EKZEKUTIVE DHE ROLI I KOMISIONEVE PARLAMENTARE

Dr. Sefedin Guri

*Këshilltar në Komisionin e Përhershëm
të Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit*

Kushtetuta i jep një rol disi të veçantë pushtetit ligjvënës si ushtrues i sovranitetit të popullit. Pushtetit ligjvënës, i cili mishërohet në veprimtarinë e Kuvendit nëpërmjet miratimit të legjisllacionit, nuk mund t'i mohohet e drejta e ushtrimit të kontrollit ndaj pushtetit ekzekutiv si në aspektin e shqyrtimit dhe të miratimit të ligjeve, ashtu dhe në aspektin e zbatimit të tyre. Mënyrat dhe format e ushtrimit të kontrollit të pushtetit ligjvënës ndaj pushtetit ekzekutiv janë të shumëllojshme e të përcaktuara në Kushtetutë, në Rregulloren e Kuvendit dhe në ligjet për krijimin dhe funksionimin e institucioneve kushtetuese.

Sipas Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 357, datë 9.4.1998, ndryshuar me vendimin nr. 399, datë 4.2.1999, kontrolli i Kuvendit ushtrohet nëpërmjet pyetjeve dhe interpelancave, mocioneve dhe hetimit të çështjeve të veçanta.

Kontrolli i Kuvendit ndaj pushtetit ekzekutiv, sipas kësaj Rregulloreje, ushtrohet edhe nga komisionet e përhershme të tij, të cilat sipas fushave që mbulojnë, shqyrtojnë raporte, njoftime ose sqarime me shkrim, të paraqitura nga ministra ose drejtues të institucioneve të tjera qendrore. Komisionet, pas diskutimit të çështjeve që raportohen, sipas rastit, i propozojnë Kuvendit ose Këshillit të Ministrave masat përkatëse.

Cilat janë çastet kryesore të ushtrimit të kontrollit të pushtetit ligjvënës ndaj pushtetit ekzekutiv?

Çasti i parë i ushtrimit të kontrollit ndaj pushtetit ekzekutiv fillon që me miratimin e Kryeministrit, ku sipas pikës 2 të nenit 96 të Kushtetutës, Kuvendi ka të drejtë të miratojë ose të mos miratojë kryeministrin, ndërsa sipas nenit 97, kryeministri i miratuar nga Kuvendi paraqet për miratim në Kuvend, brenda 10 ditëve, programin politik të Këshillit të Ministrave së bashku me përbërjen e tij. Pas miratimit të programit dhe përbërjes së Këshillit të Ministrave, Kuvendi ka nën kontroll veprimtarinë e pushtetit ekzekutiv për zbatimin e programit të miratuar, i cili realizohet gjatë procesit të ndryshimit dhe miratimit të projektligjeve, ashtu edhe nëpërmjet pyetjeve dhe interpelancave që kërkohen nga deputetë ose grupe deputetësh për probleme të ndryshme që shqetësojnë banorët e zonave urbane dhe rurale.

Çasti i dytë i ushtrimit të kontrollit të pushtetit ligjvënës ndaj pushtetit ekzekutiv, i cili realizohet nga komisionet e përhershme të Kuvendit, është procesi i shqyrtimit dhe i miratimit të projektligjeve që Këshilli i Ministrave dërgon për shqyrtim e miratim në Kuvend. Ky është një çast shumë i rëndësishëm, sepse gjatë diskutimit të projektligjeve në komisionet e përhershme të Kuvendit, projektligji analizohet në tërë kompleksitetin e tij, politik, ekonomik e social dhe nëse është ose jo në përputhje me Kushtetutën dhe me programin që ka miratuar Kuvendi për mandatin qeverisës.

Cili është roli i komisioneve të përhershme të Kuvendit në ushtrimin e kontrollit të pushtetit ligjvënës ndaj organeve të pushtetit ekzekutiv?

Komisionet e përhershme të Kuvendit luajnë një rol të veçantë në kontrollin e pushtetit ekzekutiv në fushën e objektivave sociale dhe financave publike, të cilat zënë një vend të rëndësishëm në Kushtetutë. Arritja e objektivave sociale të përcaktuar në nenin 59 të Kushtetutës, sipas të cilit shtetit, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon: punësimin e personave të aftë për punë; plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim, për kujdes shëndetësor, për arsimim dhe kualifikim, një mjedis të

shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm; shfrytëzimin racional të burimeve natyrore; përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët dhe të paaftët; zhvillimin e sportit dhe mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare dhe kujdesin e veçantë për gjuhën shqipe.

Arritja e objektivave sociale është e kushtëzuar nga fuqizimi i financave publike, prandaj edhe sipas Kushtetutës, është Kuvendi që vendos për taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare dhe vendore, që autorizon me ligj marrjen e kredive nga shteti dhe garantimin e huave dhe miraton çdo vit Buxhetin e Shtetit. Duke qënë se “Buxheti i Shtetit është instrumenti financiar kryesor për zbatimin e politikave ekonomike dhe sociale të shtetit” dhe duke qënë se përmbushja e objektivave sociale nga shteti është në varësi të mjeteve që disponon Këshilli i Ministrave, në procesin e shqyrtimit dhe të miratimit të ligjit për Buxhetin e Shtetit angazhohen të gjitha komisionet e përhershme të Kuvendit, të cilat shqyrtojnë projektbuxhetin për financimin e veprimtarive të sektorëve sipas fushave që mbulojnë dhe bëjnë vlerësimin e objektivave ekonomike e sociale, që parashikohet të arrihen për vitin financiar përkatës, si dhe propozojnë ndryshime të treguesve të buxhetit. Por, Komisioni i Përhershëm i Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit ka rolin kryesor në shqyrtimin e projektbuxhetit, sepse gjatë shqyrtimit të tij ai kontrollon projektbuxhetin në të gjitha aspektet e tij. Komisioni i Ekonomisë shqyrton treguesit makroekonomikë të pasqyruar në projektbuxhet, si dhe bashkërendon dhe shqyrton propozimet e komisioneve të tjera të Kuvendit për ndryshimin e treguesve të projektbuxhetit, duke synuar në rritjen e të ardhurave dhe të shpenzimeve, pa rritur deficitin buxhetor të projektuar nga Këshilli i Ministrave.

Vitet e fundit, procesi i shqyrtimit dhe miratimit të projektbuxhetit dhe i paketës së projektligjeve fiskale, është arritur të bëhet para mbylljes së vitit financiar, është bërë më tepër transparent për publikun, janë marrë takime dhe janë bërë këshillime me përfaqësues të biznesit dhe janë ballafaquar mendimet për paketën e projektligjeve fiskale.

Komisionet e përhershme të Kuvendit dhe sidomos Komisioni i Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit ka kërkuar sqarime dhe informacione me të dhëna plotësuese nga Ministria e Financave dhe nga ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore, për të gjetur mundësi për rritjen e të ardhurave, duke marrë masa për kufizimin e evazionit fiskal, si dhe për përdorimin e tyre për financimin e ekonomisë dhe të sektorëve socialë e kulturorë. Komisioni i Ekonomisë, në shqyrtimin e projektligjeve të rëndësishme që kanë të bëjnë me reformën ekonomike, ka tërhequr edhe mendimin e kualifikuar të shoqërisë civile. Por, tërheqja e mendimit të shoqërisë civile në procesin e shqyrtimit të projektligjeve ka qënë në një farë shkalle e kushtëzuar edhe nga koha që ka pasur Komisioni në dispozicion për shqyrtimin e tyre, kohë kjo, që në shumë raste ka qënë e kufizuar, për shkak të nevojave urgjente për miratimin e projektligjeve.

Komisioni i Ekonomisë në procesin e shqyrtimit të projektligjeve ka luajtur një rol konstruktiv. Ai ka nxitur dhe mbështetur nismat ligjvënëse të Këshillit të Ministrave për ndryshime thelbësore në politikën fiskale dhe në fushat e tjera të ekonomisë, financave dhe privatizimit të pronës shtetërore. Në këtë proces Komisioni i Ekonomisë ka përmirësuar projektligjet, duke propozuar ndryshime thelbësore në përmbajtjen e tyre, të cilat kanë synuar liberalizimin e tregut dhe nxitjen e biznesit vendas për të investuar në fushën e prodhimit dhe të shërbimeve. Propozimet e Komisionit të Ekonomisë për ndryshimin e projektligjeve të ardhura nga Këshilli i Ministrave janë pranuar nga përfaqësuesit e Këshillit të Ministrave dhe janë miratuar nga Kuvendi.

Duke ju përmbajtur nenit 82 pika 2 të Kushtetutës, Komisioni i Ekonomisë, nismat për ndryshimin e ligjeve nga deputetë të veçantë apo grup deputetësh, të cilat kanë efekte financiare në Buxhetin e Shtetit, nuk i ka shqyrtuar pa marrë më parë mendimin e Këshillit të Ministrave.

Për funksionimin sa më normal të institucioneve ekzekutive të shtetit është e nevojshme të ngrihet niveli e cilësia e ushtrimit të kontrollit të pushtetit ligjvënës ndaj pushtetit ekzekutiv në disa drejtime kryesore:

Së pari, për zbatimin e detyrimit ligjor, që ka pushteti ekzekutiv për

nxjerrjen në kohë të akteve nënligjore, në zbatim të ligjeve që ka miratuar Kuvendi, në ato rastet, kur sipas nenit 118 pika 2 të Kushtetutës ligji autorizon nxjerrjen e akteve nënligjore dhe organin kompetent, për çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave duhet të nxirren këto akte. Ky çast është i lidhur me respektimin rigoroz të nenit 117 pika 1 të Kushtetutës në të cilin thuhet se “Ligjet, aktet normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave, të institucioneve të tjera qendrore marrin fuqi juridike vetëm pasi botohen në Fletoren Zyrtare”.

Së dyti, për zbatimin e detyrimeve të ndërsjella që rrjedhin nga marrëveshjet që janë lidhur nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë me vendet e tjera dhe me institucione financiare ndërkombëtare për financimin e sektorëve të ndryshëm të ekonomisë dhe që janë miratuar ose ratifikuar nga Kuvendi. Ngritja e nivelit të kontrollit të Kuvendit dhe të komisioneve të përhershme të tij në këtë fushë është me ndikim pozitiv në përfundimin dhe vënien në shfrytëzim në kohë të objekteve që financohen nga banka e institucione financiare ndërkombëtare.

Së treti, për kontrollin e financave publike. Për këtë çështje kontrolli mund të ushtrohet në dy drejtime kryesore:

- Në përmirësimin e vazhdueshëm të legjislacionit, për të mbyllur hapësirat ligjore që lënë shteg për keqinterpretime të ligjeve, nga ku përfitojnë në mënyrë të paligjshme biznesmenë dhe nëpunës ose funksionarë të administratës shtetërore që përfshihen në vorbullën e korrupsionit.

- Në ushtrimin e kontrollit të ligjvënësisë në fushat e përdorimit të fondeve të buxhetit dhe në fushat nga ku sigurohen të ardhurat e Buxhetit të Shtetit, sepse në këto fusha ndeshen raste më të shpeshta të korrupsionit.

Duke qenë se sipas “Konventës civile për korrupsionin”, nënshkruar në nëntor të vitit 1999 në Strasburg nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe shtete të tjera të Komunitetit Europian, të cilën Republika e Shqipërisë e ka ratifikuar më 6 korrik të vitit 2000, korrupsioni përfaqëson një rrezik të madh për shtetin juridik, demokracinë dhe të drejtat e njeriut, pastërtinë dhe drejtësinë shoqërore, që pengon zhvillimin ekonomik dhe rrezikon

funksionimin e drejtë të ekonomisë së tregut, me pasoja të dëmshme financiare ndaj individëve, kompanive dhe shteteve, si dhe ndaj institucioneve ndërkombëtare. Janë këto shkaqet që kjo Konventë i detyron palët pjesëmarrëse të parashikojnë në ligjet kombëtare rregullime efektive për personat që dëmtohen si rezultat i veprimeve korruptive, t'u japë atyre mundësi të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre, duke përfshirë edhe mundësinë për t'u kompensuar për dëmin.

Korrupsioni është bashkudhëtar i shoqërisë njerëzore dhe, si i tillë, ai nuk mund të zhduket, por shoqëria, duke vendosur ligje dhe duke i ndëshkuar personat që shfrytëzojnë pushtetin për përfitim të padrejtë, mund ta minimizojnë atë dhe ta bëjë të padëmshëm për shoqërinë.

Gjatë dhjetë viteve të periudhës së tranzicionit është arritur të plotësohet në një masë pothuajse të plotë kuadri ligjor për reformën ekonomike. Kjo krijon kushte që në të ardhmen komisionet e përhershme të Kuvendit të kenë më shumë kohë në dispozicion, në funksion të përmirësimit të punës për kontrollin e organeve ekzekutive, duke organizuar seanca mbledhjesh për të dëgjuar drejtuesit e ministrive dhe të institucioneve qendrore për probleme që komisionet çmojnë se kërkojnë zgjidhje dhe për të cilat kërkohet një angazhim më i madh i Këshillit të Ministrave, duke i bërë objekt të pyetjeve dhe interpelancave me ose pa debat në seancat plenare të Kuvendit.

Informacion mbi veprimtaritë e organizmave ndërkombëtare

Leon Shestani

Progresi i Paktit të Stabilitetit për Europën Juglindore në fushën ekonomike është lançuar në mesin e vitit 1999. Mund të vërehet se Pakti vazhdon të jetë i një rëndësie jetësore për rindërtimin ekonomik në rajon, si dhe për paqen e stabilitetin.

Sidoqoftë, mund të thuhet se Pakti i Stabilitetit ka nevojë për një drejtim me të fortë administrativ, për një angazhim më të madh të donatorëve, për një bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet vendeve që përfitojnë nga Pakti dhe implementim me të shpejtë të projekteve, veçanërisht në kuadër të së ashtuquajturës “Paketa me fillim të menjëhershëm (Quick Start Package)”.

Është vlerësuar se në përgjithësi ka pasur vonesa dhe mospërmbushje të agazhimeve nga ana e vendeve përfituese të paktit në drejtim të krijimit të një mjedisi të përshtatshëm për zhvillimin e biznesit dhe të investimeve, të reduktimit të barrierave tregtare, të luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Gjithashtu, mund të thuhet se është tepër e nevojshme të përmirësohet bashkërendimi ndërmjet organizatave të ndryshme ndërkombëtare, si dhe programet e tyre. Po ashtu, duhet krijuar një mekanizëm raportimi periodik i agjencive zbatuese për stadin e implementimit të projekteve dhe programeve të paktit.

Duhet theksuar se zhvillimi ekonomik ka një lidhje të pandashme nga zhvillimi i demokracisë, shtetit ligjor dhe i respektimit të të drejtave të njeriut. Po ashtu, edhe bashkëpunimi në fushën e arsimit dhe të kulturës përbën një mjet shumë të fuqishëm për krijimin e një klime tolerante dhe mirëkuptimi në rajon.

Po kështu, sfida kyç për rikonstruktimin dhe zhvillimin ekonomik të Europës Juglindore është formulimi dhe implementimi i strategjive të zhvillimit teknologjik

në EJL. Mirëpo, formulimi i strategjive teknologjike arrihet vetëm atëherë kur ekzistojnë bazat dhe themelet e operimit të një ekonomie të tregut të lirë dhe të një shoqërie demokratike.

Këto argumente janë paraqitur në seancën e debateve të sesionit të dimrit të Këshillit të Europës (Asambleja Parlamentare), ku tema e paktit të stabilitetit zuri një vend të veçantë me dy debate:

- për implementimin e aspekteve ekonomike të Paktit të Stabilitetit dhe
- për strategjitë teknologjike për rikonstruktimin dhe zhvillimin ekonomik të Europës Juglindore.

Faqja e paktit të stabilitetit: www.stabilitypact.org

Faqja e Këshillit të Europës: www.coe.int

Disa nga rekomandimet e përmbledhura për këto dy çështje janë:

1. Implementimi i aspekteve ekonomike të Paktit të Stabilitetit

- Shpejtimi i masave për arritjen e integritit të tregjeve të rajonit me Bashkimin European

Vendet e rajonit vlerësojnë si objektiv të tyre strategjik integrimin në Bashkimin European dhe strukturat euroatlantike. Të gjitha veprimtaritë në kuadër të Paktit të Stabilitetit synojnë të afrojnë vendet e rajonit me standardet, praktikat, rregullat dhe vlerat europiane. Procesi i lancuar me firmosjen e marrëveshjeve të asocimit dhe stabilizimit përbën një element kyç në këtë rrugë, si mishërimi i politikës së BE-së për rajonin.

Hapi i parë konkret drejt integritit të mundshëm në strukturat europiane dhe globale është integrimi i regjimeve tregtare. Ka argumente të shumta që tregojnë se integrimi i tregjeve është një faktor shumë i rëndësishëm në rrugën e madhe të integritit afatgjatë. Vendet e Europës Juglindore janë të vogla. Prandaj zhvillimi i tyre varet në mënyrë kritike nga tregjet ndërkombëtare dhe aksesit në tregjet europiane.

Integrimi tregtar është thelbësor për reduktimin e varësisë së vendeve të rajonit nga ndihmat e komunitetit european. Kjo duhet të shoqërohet me krijimin e sektorit privat kompetitiv dhe të larmishëm. Pa përmirësimin e klimës së përgjithshme të

investimeve në veprimtaritë private, vendet e rajonit do ta kenë të pamundur të realizojnë dhe të prekin të mirat e integritimit tregtar, si dhe nuk do të jenë në gjendje të krijojnë vende të reja pune, jetike për rritjen e standardit të jetesës.

Sfida kryesore në këtë fushë për vendet e rajonit është liberalizimi i përgjithshëm i regjimeve tregtare dhe forcimi i institucioneve të tilla, siç janë doganat. Një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet shmangies së pengesave burokratike për tregtinë ndërrajonale, siç janë kontrollet administrative për lëvizjen e të mirave materiale dhe shërbimeve.

- Financimi i institucioneve, kapaciteteve qeverisëse të strukturave qeveritare dhe forcimi i luftës kundër korrupsionit

Nxitja dhe mbështetja e zbatimit të reformave konkrete institucionale dhe ekonomike është një përparësi për partnerët e Paktit të Stabilitetit. Zhvillimi i infrastrukturës dhe i sektorit privat të vendeve të rajonit të Europës Juglindore është i domosdoshëm për një rritje të qëndrueshme ekonomike e të tregtisë dhe investimeve rajonale. Pa zbatimin e reformave të thella nuk mund të arrihet progres i dukshëm. Është fakt, që asistenca financiare ndërkombëtare nuk do të ketë efektin e dëshiruar përdërisa ekonomitë e vendeve të rajonit të shndërrohen në përputhje me parimet e ekonomisë së tregut, administrata publike të përmirësohet, si dhe shoqëria civile të zhvillojë me tej praktikën demokratike.

Zhvillimi ekonomik dhe stabiliteti në rajon do të varen në masë të konsiderueshme nga forcimi i institucioneve, qeverisja e mirë dhe ulja e nivelit të korrupsionit. Integrimi gradual me strukturat europiane dhe globale do të kërkojë struktura institucionale në një nivel shumë më të zhvilluar se në stadin aktual. Institucionet kanë një rol tejet të rëndësishëm në uljen e nivelit të varfërisë dhe në sigurimin e shërbimeve të domosdoshme publike.

Vlerësimet dhe evidencat që ekzistojnë aktualisht tregojnë se vendet e rajonit kanë institucione dhe qeverisje të dobët. Ato frenojnë zhvillimin ekonomik dhe dëmtojnë perceptimin e investitorëve të rajonit.

Një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar luftës kundër korrupsionit. Axhenda për veprim në këtë fushë është shumë e gjerë dhe përfshin rritjen e transparencës dhe të përgjegjësisë në funksionimin e institucioneve shtetërore, përmirësimin e

mekanizmave të kontrollit, përfshi këtu kontrollet financiare dhe manaxhimin e fondeve, reduktimin e sekreteve administrative dhe një pjesëmarrje më të madhe dhe mbikëqyrje të shoqërisë civile.

Pakti ka stimuluar atë që tashmë quhet “mendim rajonal” të vendeve të Europës Juglindore. Kjo ka bërë që të ketë një rritje të ndjeshme të bashkëpunimit rajonal. Kjo prirje duhet të vazhdohet të mbështetet dhe të shihen rrugë të tjera për nxitjen e bashkëpunimit dypalësh dhe shumëpalësh që synojnë marrëveshje në fusha të ndryshme.

- Rritja e investimeve në infrastrukturë me synim integrimin fizik të rajonit me pjesën tjetër të Europës

Rritja ekonomike dhe integrimi rajonal do të varen në mënyrë kritike nga zhvillimi dhe rritja e efikasitetit të infrastrukturës bazë.

Në kuadër të Paktit të Stabilitetit, Banka Europiane e Investimeve, në bashkëpunim me institucione të tjera ndërkombëtare financiare dhe me Komisionin European, ka hartuar një program shumë të mirë për përmirësimin e infrastrukturës rajonale, të mbiquajtuar “Paketa me fillim të menjëhershëm”. Kjo paketë përfshin mbi 200 projekte që kushtojnë rreth 400 milionë euro. Vendet donatore i kanë dhënë një rëndësi të veçantë paketës antikorrupsion në implementimin dhe lëvrimin e burimeve financiare të këtyre projekteve.

Komisioni i Ekonomisë dhe Zhvillimit i Këshillit të Europës shfaqi rezervat e tij për ritmet e zbatimit të projekteve, duke konkluduar se paketën në fjalë do të ishte më mirë ta quanim me “fillim të ngadalshëm”. Gjithashtu, ky Komision shfaq mendimin për nevojën e thjeshtimit e procedurave të implementimit të projekteve, si dhe vëren me keqardhje se disa donatorë nuk i kanë përmbushur angazhimet e tyre. Të gjitha palët duhet të jenë të saktë në zbatimin e angazhimeve të tyre.

2. Strategjitë teknologjike për rikonstruktimin dhe zhvillimin ekonomik të Europës Juglindore

Nevoja e formulimit të strategjive teknologjike mbetet një sfidë shumë e rëndësishme për prosperitetin e vendeve të rajonit të Europës Juglindore. Ky është një faktor i rëndësishëm për paqen, demokracinë dhe zhvillimin e

qëndrueshëm në rajon me synim integrimin në Europë. Në dhjetëvjeçarët e fundit ritmi i zhvillimit të teknologjive në rajon ka pësuar një ngadalësim. Produktet janë më pak kompetitive në tregun botëror.

Anëtarësia në Bashkimin Europian, që përbën një përparësi të vendeve të Europës Juglindore, do të thotë përmbushje e kriterëve të Kopenhagenit, që është e pamundur të realizohen pa një rivlerësim të strategjive të rindërtimit të teknologjive në të tërë rajonin.

Strategjitë teknologjike mund të përmirësohen vetëm kur bazat e zhvillimit të jenë të shëndosha:

i. Respektimi i parimeve demokratike, të të drejtave të njeriut dhe shtetit ligjor.

ii. Përparimi thelbësor në drejtim të rregullave të ekonomisë së tregut, krijimi i një mjedisi të ndershëm dhe të qëndrueshëm për investime, liberalizimi i tregjeve dhe shërbimeve, zhvillimi i një procesi të tejdukshëm privatizimi.

iii. Marrja e masave ligjore dhe administrative për të dekurajuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, si dhe për të garantuar një mjedis të qetë dhe të qëndrueshëm për investimet.

iv. Rinovimi i infrastrukturës së transportit, të shpërndarjes së energjisë dhe të telekomunikacioneve është thelbësor për integrimin e rajonit.

Lidhur me sektorin e energjise duhet theksuar së drejtimet e zhvillimit të tij duhet të jenë:

i. Zbatimi i teknologjive të reja në prodhimin e energjisë, duke përmirësuar produktivitetin dhe duke reduktuar kostot e prodhimit.

ii. Krijimi i komunitetit të energjisë së vendeve të Europës Juglindore, bazuar në administrim të përbashkët të sigurisë së energjisë dhe me zhvillimin e burimeve të reja të rezervave të energjisë.

iii. Nxitja e investimeve dhe transferimi i teknologjive moderne në vendet e EJL-së, për të rritur kapacitetin e prodhimit të energjisë dhe eficientë.

Gjithashtu, u theksua nevoja jetësore e shtrirjes së investimeve në drejtim të teknologjive të reja, të komunikimit në largësi, të prodhimit të soft dhe hardware etj.

AKTIVITETE TE QENDRES STUDIMORE MBI PRAKTIKAT PARLAMENTARE DHE DEMOKRATIKE

Elira ZAKA
Koordinatorë QSPDP

Qendra Studimore mbi Praktikën Parlamentare dhe Demokratike u krijua si një nismë e përbashkët e disa prej ish-këshilltarëve të Parlamentit me dëshirën dhe aspiratën për të kontribuar në zhvillimin dhe rritjen e efektivitetit në veprimtarinë parlamentare, procesin legjislativ dhe zhvillimin e demokracisë parlamentare përmes ndërmarrjes së studimeve e kërkimeve, organizimit të aktiviteteve dhe trajnimit.

Duke qenë se drejtimit bazë të veprimtarisë së Qendrës janë procesi legjislativ dhe procedura parlamentare; statusi i deputetit; kontrolli parlamentar; çështjet që lidhen me ushtrimin e të drejtës elektorale dhe pjesëmarrjes së publikut në procesin ligjvënës; teknika legjislative; diplomacia parlamentare; shërbimet parlamentare dhe infrastruktura bashkëkohore në efektivitetin e parlamentit, si dhe transparenca në parlament, edhe aktiviteti i deritanishëm i Qendrës ka synuar të përmbushë pikërisht këto “detyrime”.

Në këtë kuadër, u ndërmorr edhe një nga aktivitetet e para të Qendrës, **Konferenca mbi Efektivitetin në Procesin Legjislativ**, mbajtur më 13-14 prill 2000, realizuar me mbështetjen dhe bashkëpunimin e Fondacionit gjerman Fridrich Ebert.

Konferenca synonte identifikimin e problemeve dhe dobësive ne procesin legjislativ; analizën e rregullave dhe praktikës së këtij procesi; përgatitjen e rekomandimeve për unifikimin dhe institucionalizimin e praktikës për përmirësimin e këtij procesi; identifikimin e instrumenteve për rritjen e transparencës dhe pjesëmarrjes së publikut në procesin legjislativ, si dhe rritjen e njohurive dhe ndërgjegjësimin për rëndësinë e një procesi legjislativ të mirë-organizuar.

Në Konferencë ishin ftuar të merrnin pjesë deputetë, anëtarë të Këshillit të Ministrave, specialistë të zyrave juridike dhe kabineteve të ministrive si dhe nga Këshilli i Ministrave, përfaqësues nga Stafi i Kuvendit, Presidenca, përfaqësues nga shoqëria civile dhe media dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare me seli në Tiranë.

Konferenca u konceptua në katër panele dhe subjektet të cilave u drejtohej ishin autoritetet përgjegjëse për bërjen e politikave, zyrat juridike pranë ministrive dhe ato qendrore në Këshillin e Ministrave, deputetët, zyrat përgjegjëse të stafit në Kuvend, e zyra juridike në Presidencë. Cdo panel do të trajtonte një aspekt të rëndësishëm të procesit legjislativ.

Pjesëmarrja e gjërë dhe niveli i lartë i diskutimeve në Konferencë treguan interesin dhe dëshirën e përbashkët për të përmirësuar procesin legjislativ në të gjitha hallkat e tij.

Marrëdhëniet Deputet-Zgjedhës, Për një rritje të nivelit të përfaqësimit dhe të besimit tek institucionet, projekt i mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, SOROS;

Ky projekt ka si qëllim të përmirësojë punën e Deputetëve me elektoratin në drejtim të rritjes së shkallës së përfaqësimit dhe të pjesëmarrjes së këtij të fundit në jetën politike, me synim forcimin e demokracisë dhe zhvillimin e institucionit të Legjislativit. Në këtë kuadër synohet të rritet gjithashtu, besimi i publikut tek institucionet, në mënyrë të vecantë tek Kuvendi, në kuptimin dhe hapësirën që kërkohet nga respektimi i parimit të legjitimitetit.

Qendra vlerësoi se, realizimi i një projekti i cili do të identifikonte

problemet që lidhen me përfaqësimin dhe çështjen e besimit të publikut tek institucionet si dhe paraqitja e sugjerimeve dhe rekomandimeve për marrjen e masave dhe iniciativave edhe ligjore për përmirësimin e këtyre marrëdhënieve, do të ishte një kontribut në zhvillimin e praktikave demokratike dhe të jetës parlamentare.

Nëpërmjet këtij projekti, Qendra synon vëzhgimin dhe identifikimin e problemeve që lidhen me marrëdhënien deputet-zgjedhës në drejtim të përfaqësimit; vëzhgimin dhe identifikimin e problemeve që lidhen me marrëdhëniet deputet-pushtet vendor; zhvillimin dhe ndërjegjësimin e opinionit publik për rëndësinë e pjesëmarrjes në jetën politike; zhvillimin e njohurive dhe mundësive të deputetëve në drejtim të kontaktit dhe përfaqësimit të zgjedhësve, duke përfshirë dhe studime krahasuese mbi përvojat e vendeve të tjera; zhvillimin e të kuptuarit që kanë zgjedhësit për procesin e vendimmarrjes, si dhe i besimit të tyre në institucionin e Kuvendit.

Aktualisht janë zhvilluar misione vëzhgimi në tri qytete: Elbasan, Shkodër dhe Gjirokastrë. Në këto misione është marrë informacion nga publiku i gjerë për njohuritë e tij mbi veprimtarinë dhe qëndrimet e deputetit të zonës. Këto informacione dhe studimet paraprake të kryera do të jenë bazë për tryezat e rumbullakëta që do të zhvillohen në qytetet e përmendura më sipër.

Zhvillimin e Sesioneve Informuese mbi çështje ligjore për Komisionet Parlamentare, realizuar në bashkëpunim me International Republican Institute (IRI). Sesionet Informuese synojnë kryesisht t'u sigurojnë deputetëve një analizë të çështjeve ligjore, pra një shikim alternativ të dhënë nga ekspertë të pavarur, gjë që do të promovonte një diskutim joformal për çështje thelbësore ndërmjet deputetëve dhe partive politike, do t'u ofronte deputetëve një kuptim më të qartë për adresimin e çështjeve ligjore, si dhe do të conte në përmirësimin e vendimeve që lidhen me legjislacionin. Qëllimi i sesioneve informuese është, gjithashtu, rritja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në procesin e marrjes së vendimeve si dhe të transparencës së këtij procesi.

Janë realizuar tri sesione informuese mbi çështje ligjore, të tilla si, Pastrimi i Parave, Informacion dhe Debat mbi Organizimin dhe Funksonimin e Pushtetit Vendor, si dhe sesion informues mbi Krijimin e Task Force për Sistemin e Energjisë Elektrike.

Ky është një program në vazhdim, që nënkupton zhvillimin e sesioneve të tjera informuese mbi çështje ligjore.

Hartimi i Ligjit mbi Funksonimin e Komisioneve Parlamentare Hetimore, organizimi i tryezës së rrumbullakët për diskutimin e këtij projekt-ligji. Projektligji “Për Rregullat e Funksonimit të Komisioneve Hetimore Parlamentare” u përgatit nga Grupi i Punës së deputetëve, propozuar në mbledhjen e përbashkët të Komisionit të Ligjeve dhe atij të Rregullores, Mandateve dhe Imunitetit, dhe me mbështetjen teknike të ekspertëve të Qendrës Studimore mbi Praktikën Parlamentare dhe Demokratike (QSPDP) dhe Institutit të Studimeve Bashkëkohore (ISB). Projekt-ligji synon të rregullojë një nga aspektet e rëndësishme të aktivitetit parlamentar dhe njëkohësisht ai plotëson një detyrim kushtetues. Përgatitja e tij është mbështetur në eksperiencat parlamentare ndërkombëtare dhe në eksperiencën e deritanishme të Kuvendit të Shqipërisë.

Në këtë kuadër u organizua tryeza për diskutimin e projekt-ligjit në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Institutit të Studimeve Bashkëkohore (ISB), në koordinim me Komisionin e Ligjeve dhe Çështjeve Kushtetuese e Komisionin e Mandateve, Imunitetit dhe Rregullores.

